URIMI I MYFTIUT ME RASTIN E FILLIMIT TË TRE MUAJVE TË MIRË

"EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)"

SI DHE PËRSE ËSHTË ZGJEDHUR EZANI PËR THIRRJE NË NAMAZ?

Viti XVI - Nr. 3 (181), Mars, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme Informative - Fetare Kulturore - Edukative

KONFERENCA E 7-TË VJETORE E IMAMËVE, TEOLOGËVE DHE THIRRËSVE ISLAMË TË SHKODRËS

Familja, baza e qytetërimit dhe e shoqërisë njerëzore

SIRIA, MATËSI I VËRTETË I QYTETËRIMIT TË SOTËM...

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Imagjinoni se çfarë civilizimi e qytetërimi është ky, që lejon shkatërrimin e djepit të civilizimeve dhe qytetërimeve botërore; Sirinë!

Imagjinoni, kasaphana e Sirisë ka mbi shtatë vite, që nuk ngohpet me gjak dhe shpirtra të dhunuar. Qindra mijëra jetë të pafajshme, sa e sa fëmijë të mitur, vajza të reja, nëna me fëmijë në gji e të tjera në pritje të gëzimit të parë...

Vrasje e shkatërrime masive me të gjitha llojet e armëve dhe makinerive të shkatërrimit në masë, thuajse në heshtje botërore!

Sa e sa objekte kulti historike, deri shekullore, të shkatërruara, të djegura e të bombarduara! Varre heronjsh, sahabësh e eulijashë me emër, të dhunuara e të thyera! Nuk shpëtoi i gjallë, as i vdekur nga kjo çmenduri shejtanore!

Miliona muhaxhirë sirianë gjithandej, anembanë botës... (Tek Zoti i gjithësisë, nuk do të tretet asnjë hise e sinqeritetit dhe solidaritetit të asnjë shteti ndaj tyre, njësoj si nuk do të harrohet asnjë barbarizëm e sjellje çnjerëzore e shumëkujt ndaj tyre!)

Imagjinoni tash, përfaqësues të ndryshëm të civilizimit të armëve bërthamore dhe krimeve pafund ndaj njerëzimit, bashkë me ata të qytetërimit të mashtrimit, korrupsionit, gënjeshtrës dhe hiles, teksa së bashku, a veç e veç, vijnë e të flasin për tolerancë e harmoni, për modele "Islamesh" pa yndyrë e tëmth, për dialog qytetërimesh e të ngjashme..!?

Prandaj, detyrimisht duhet të ketë një rizgjim të Islamit të vërtetë dhe njerëzve të urtë që e njohin besën e Zotit dhe hakun e robit, për të shkelmuar gjithë këtë hipokrizi e nihilizëm ekstrem, që ka për tendencë të kthejë në manekinë bajatë e të pafytyrë, deri edhe shumë pretendues të fetarizmit a të fabrikuar për këtë gjë!

Siria, matësi i vërtetë i qytetërimit të sotëm, e nxori të falsifikuar atë, para syve të mbarë njerëzimit!

DAMASKU...

Damasku! A mund të përshkruhet Damasku? A mud të përshkruhet xheneti para dikujt, që s'e ka parë atë? Kush mund ta përshkruajë atë, që është një botë ëndrrash dashurie, lavdie trimërishë dhe mrekullie përjetësishë? Kush mund të shkruajë për të, me lapsat e kësaj bote të përkohshme, kur ajo është një copëz e xheneteve të përjetshme?

Damasku, të cilin e mban në gji mali kryelartë e krenar, në mes të shkëmbinjve, pemëve, kodrinave mbi tokë...

Damasku, të cilin e përqafon GUTA, kjo nënë e dhembshur, përherë në gjelbërim, që dëgjon me vëmendje lutjet përgjëruese të duarartave që mbushin ujë burimesh dhe zhurmën e gurgullimave të ëmbla të krojeve të Beredasë, që rrjedh pa pushim në drejtim të lindjes së diellit, teksa vrapon gjithë natën drejt tij, për ta kaluar, teksa ai lind...

Damasku, që ruhet nga Rebvaja, syhapur në mihrabin e saj shkëmbor, në madhërim e falënderim ndaj All-llahut, që i dha gjysmën e bukurisë, njëkohë që gjysmën tjetër e ndau në cepat e tjerë të botës...

Rebvaja, nuk është asgjë tjetër, veçse një ëndërr e bukur, plot mister, që pushton zemrën e soditësit të saj me më të bukurat ndjesi, që ka përjetuar ndonjëherë një zemër njerëzore... Secilit i kujton netët e dashurisë së saj dhe orët e lumturisë, pastaj ëndrra venitet duke u kthyer në një kujtim të ëmbël, që s'e fshin dot asnjë ndodhi, as e mbulon dot rrjedha e kujtimeve...

Rebvaja është tingull, prej tingujve të qiellit, që e ka luajtur vetëm një herë për veshin e tokës! Rebvaja është Rebvaja, për ata që s'e njohin dhe kaq!

(Rebvaja (Er-Rebveh), zgjatet në një luginë mes dy malesh; mali Kasijun perëndimor dhe mali Mizze lindor, drejt perëndimit të fushës së Damaskut. Aty rrjedh lumi Bereda me shtatë degëzimet e tij, ndërsa ujvarat derdhen mrekullisht nga lart poshtë. Sot, përgjatë saj shtrihet rruga drejt Libanit. Ibn Batuta e vizitoi Rebvenë, në shekullin e tetë hixhri dhe pasi u kthye në Tanxha, pas ekspeditave të tij të famshme, shkroi për të: "Prej panoramave më të bukura të botës...")

Damasku është qyteti më i lashtë i botës, më i moshuari ndër ta, më i pjekuri në qytetërim! Ishte qytet i begatë, para se të lindej Bagdadi dhe Kajroja, Parisi dhe Londra. Para se të zinin zanafillë piramidat dhe të gdhendej në shkëmb fytyra e Ebul-Houlit. Ai mbeti qytet i begatë, edhe pasi u shuan qytete të tëra dhe gjurmët e tyre.

Në Damask është grumbulluar trashëgimia e krejt kohërave! Banorëve të saj sot, i kanë kaluar krejt veçoritë e banorëve të saj të lashtë; në shpirtrat e tyre ka ngjyresa, njësoj si ato të tokës së tij, prej gjurmëve të qytetërimit dhe trashëgimisë së të shkuarës, shtresë mbi shtresë. Civilizimi rrjedh në venat e tyre, bashkë me gjakun, ata janë trashëgimtarët e tij dhe mbartësit e flamurit të tij; civilizimi ndër ta, është natyrë e lindur!

> **Kasaphana e Sirisë ka mbi shtatë vite. Qindra mijëra jetë të pafajshme, sa e sa fëmijë të mitur, vajza të reja, nëna me fëmijë në gji e të tjera në pritje të gëzimit të parë... Vrasje e shkatërrime masive me të gjitha llojet e armëve dhe makinerive të shkatërrimit në masë, thuajse në heshtje botërore!**

Cilit qytet pra, i ka dhënë All-llahu njëherazi, bukurinë e rinisë dhe prezencën plot madhështi të pleqërisë, siç ia ka dhënë Damaskut?*

...

** Nga vepra e eruditit të shquar damasken, Ali Tantavi, "Damasku", botimi i shtatë, Xhide 2014.*

URIMI I MYFTIUT ME RASTIN E FILLIMIT TË TRE MUAJVE TË MIRË 1439

Të dashur vëllezër dhe motra, besimtarë dhe bashkëqytetarë!

Më lejoni t'ju drejtohem me një lutje të përzemërt dhe me një urim të mbushur me bekim e mirësi, me rastin e fillimit të atmosferës së begatë të Tre Muajve të Mirë; Rexheb, Shaban dhe Ramazan.

Këto tre muaj, janë një periudhë e re kohore, që na vjen si një mundësi tjetër nga Zoti i gjithësisë, për t'u penduar e për t'u kthyer nga dyert e Dashnisë së Tij, harmonisë dhe faljes në familje, bamirësisë dhe altruizmit në shoqëri, tolerancës dhe zemërgjerësisë në marrëdhënie me tjetrin, butësisë dhe seriozitetit në marrëdhënie me njerëzit në nevojë.

Realitetet e sotme shqiptare, por edhe ato mbarëbotërore, po na vërtetojnë përherë e më shumë se jeta pa Zotin dhe vlerat e besimit, e kthen njeriun në krijesë xhungle, ku më i forti e më arroganti, dominon me padrejtësi mbi të tjerët!

Shqipëria e jonë sot, lëngon nga humbja e rrugës së udhëzimit, propagandat kundër moralit dhe fesë po e varfërojnë përherë e më shumë vendin, anashkalimi i besimit dhe zhytja në ateizëm e shekullarizëm ekstrem, imitimi i veseve dhe sjelljeve më perverse dhe më të pavlera të tjerëve, si dhe pushteti në duart e ca të paudhëzuarve, po e mjeron vendin përherë e më shumë!

Këtu, na duhet, si familje e madhe e besimit dhe vlerave të tij, të afrohemi dhe të bashkohemi, të hedhim tutje simbolet e përçarjes, të punojmë me sinqeritet për të mirën e përbashkët dhe të ardhmen e kombit dhe fëmijëve të tij!

Këto tre muaj janë stacione reflektimi, pendimi dhe rizgjimi, për të gjetur fillin e humbur këtu e një shekull më parë, për t'u kthyer te lavdia e besimit dhe madhështia e Islamit, që i nxorri shqiptarët nga injoranca në dije, nga papastërtia në dlirësi, nga prapambetja në një qytetërim vlerash, që botës i fali paqe dhe jetë!

Është koha të lutemi për njëri-tjetrin, për të mirën e vendit, për forcimin e ymetit, për pastrimin e botës sonë nga terrorizmi dhe dhuna, nga dyfytyrësia dhe korrupsioni, nga droga dhe bimët narkotike, nga krimi dhe injoranca; që sëbashku gjejnë zgjidhje tek kthimi me zemër nga All-llahu i Madhëruar dhe vendosja e pakthyeshme për të ndryshuar jetën!

Lutem me zemër për njerëzit e përmbytur në këto ditë të vështira, për skamnorët e jetimët, për nxënësit dhe studentët, për forcimin e familjes shqiptare dhe pastrimin e saj nga fenomenet vrastare të dashurisë, prehjes, qetësisë, harmonisë dhe mirëqenies në to!

All-llahu ju dashtë dhe ju begatoftë! All-llahu e begatoftë popullin dhe kombin tonë! All-llahu i dhashtë mbarësi dhe sukses mbarë ymetit islam! All-llahu e shpëtoftë njerëzinë nga e keqja! Amin!

Myftiu i Juaj,
Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 19 mars 2018

Dr. Salahudin A. Keftaro
Damask, Siri

ÇFARË MORALI I LARTË ËSHTË KY?!

Junus ibn Abdul'eala ka qenë prej nxënësve të Imam Shafiut.

Një herë, ai debatoi me Imam Shafiun për një mesele, në të cilën e kundërshtonte. Junusi u zemërua, u ngrit nga mexhlisi dhe e la Imam Shafiun e shkoi në shtëpi.

Sapo ra nata, dëgjoi të trokitej në derën e tij.

Junusi: Kush është në derë?

Ai që trokiste: Muhamed ibn Idris.

Junusi: Mendova për çdo njeri që e kishte emrin Muhamed ibn Idris, përveç Shafiun.

E hapa derën dhe u befasova.

Imam Shafiu: O Junus, jemi bashkuar për qindra mesele dhe u ndamë për një mesele të vetme!!

O Junus, mos u përpjek të triumfosh në çdo debat, sepse nganjëherë "fitimi i zemrave" është më parësor se sa "fitimi i qëndrimeve".

O Junus, mos i shemb urat, të cilat i ke ndërtuar dhe i ke kaluar, sepse ndoshta një ditë do të kesh nevojë për ta. Urre gjithmonë "gabimin", por mos urre "gabimtarin". Dhe, urre me gjithë zemrën tënde "gjynahun", por tolero dhe mëshiro "gjynahqarin".

O Junus, kritiko "thënien", por respekto "thënësin", sepse puna jon është të zhdukim sëmundjen, e jo të sëmurin".

Allahu i qoftë falënderimi!

Çfarë morali i lartë është ky?!!

SI DHE PËRSE ËSHTË ZGJEDHUR EZANI PËR THIRRJE NË NAMAZ?

(Dhe, përse nuk ka ardhur përmes shpalljes së drejtpërdrejtë?)



Shejkh Muhamed El-Gazali

Nuk di ndonjë fjalë tjetër, që meriton të dëgjohet dhe ia vlen të meditohet në të, se sa fjalët e ezanit. Dhe, nuk gjej ndonjë thirrës tjetër, që të thërrasë në udhëzim, se sa muezini. Fjalët me zë të lartë që ushtojnë në horizonte të përkujtojnë Allahun dhe të drejtat e Tij, të kujtojnë punën për të hirë të së cilës jemi krijuar. Ajo (thirrje) është ftesë për bijtë e Ademit që të njohin rrugën e drejtë e të jenë të patundur në të dhe të kenë kujdes nga rrugët e shtrembërta e të largohen prej tyre.

Kur muezini thotë: "Allahu Ekber, Allahu Ekber" dhe e përforcon duke e përsëritur, sikur ai i thotë njeriut: Mos u sill rreth vetes dhe kujto Atë që të krijoi e të përsosi, e bëje Atë qëllimin jetës, të të begatojë në kohën dhe mundin tënd: "Kush dëshiron shpërblimin e ahiretit, Ne ia shtojmë atij shpërblimin". - (Esh-Shura: 20)

Dhe, kur thotë: "Eshhedu en la ilahe il'lallah" (dëshmoj se nuk ka zot tjetër, përveç Allahut) dhe e përsërit edhe një herë tjetër, sikur ai i thotë njeriut: Mos ju frikëso zotëve të tjerë në tokë, të gjitha punët i përkasin vetëm Atij. Tek Ai përfundojnë dhe nuk ka kush e kundërshton vendimin e Tij. Nuk ka kush e ndalon atë, që Ai jep dhe nuk ka kush të jap diçka, nëse Ai e ndalon, prandaj qëndro krenar dhe mbaje kokën lart, e shko për t'i bërë sexhde Allahut, sepse ti kurrë nuk do të poshtërohesh pas Tij!

E, kur thotë: "Eshhedu enne Muhammeden resulullah" (dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Allahut) dhe e përsërit edhe një herë tjetër, ai pikturon përpara ndërgjegjes tënde pamjen e plotë njerëzore për ta marrë shembull dhe për të pasuar gjurmët e tij. Vetëm Muhammedi është shembulli i mirë në besim, përkushtim, moral dhe rrugën e drejtë.

Kur thotë: "Hajja ales-salah" (eja në namaz) dhe e përsërit edhe një herë tjetër, ai të fton të të nderohesh duke qëndruar përpara duarve të Zotit, që ta lavdërosh me falënderimin e Tij, t'i kërkosh mbështetje shtesë dhe të marrësh pjesë me vëllezërit e besimit në tubimin dhe të dashurit për hir Tijin.

Kur thotë: "Hajja alel-felah" (eja në shpëtim) dhe e përforcon me një herë tjetër, ai të bën me dije për një përpjekje frutdhënëse dhe mundim të mbarë, sepse sa të shumtë janë ata të cilët mbjellin e nuk korrin, apo vrapojnë dhe nuk mbërrijnë! Ndërsa, njerëzit namazli nuk humbasin: "Me të vërtetë Allahu i udhëzon ata të cilët kanë besuar, në rrugën e drejtë". - (Kur'ani, El-Haxh: 54)

Dhe, kur thotë për të treten herë: "Allahu Ekber, Allahu Ekber" (Allahu është më i Madhi), ai përforcon qëllimin e saktë nga kjo jetë dhe përpjekjen e mundimshme gjatë gjithë jetës. Njeriu kur del nga shtëpia për punën e tij dhe për t'ia arritur asaj që mundet prej dobive për veten dhe familjen e tij, ndërkohë buçitja e tekbirit (Allahu Ekber), të cilën e dëgjon e thërret që të ketë për qëllim Zotin e tij, e ta bëjë për Të punën e tij. Dhe, kur e paraqet veten përpara Zotit të tij, do ta gjejë atë të favorizuar e të aftë, ndërsa kush i jep përparësi vetes, do ta humbasë atë: "Mos u bëni si ata që harruan Allahun, e Ai i bëri të harrojnë veten e tyre". - (Kur'ani, El-Hashr: 19)

Ezani mbyllet me thirrjen e Teuhidit (Njësimit), për t'i rrëzuar idhujtaritë e tëra. Tani bota nuk i përkulet ndonjë idhudhi të gurtë, por ajo i këndon idhujve të gjallë , trupave të frikshëm në botën e pushtetit dhe të pasurisë, rë cilëve njerëzit u frikësohen më shumë se Zotit të zotëve.

Fjalët e ezanit janë platformë e plotë dhe thirrje e kompletuar, të cilat nuk i zëvendëson flaka e zjarrit, tingulli i kambanës, e as ushtima e bririt. Ato janë fjalë prej Zotit të Lartë, që i fton njerëzit të kthehen në origjinën e tyre qiellore të pastër.

Këto fjalë kanë zbritur nga qielli dhe nuk kanë dalë prej tokës. I dëgjuan një grup prej sahabësh në ëndrra të ngjashme dhe dikush nga melekët i shqiptoi ato pas një konference , në të cilën kërkohej, sahabët me të Dërguarin e Allahut (a.s) për mënyrën më të bukur në thirrjen për namaz! Biseda këtu na kthen te përgjigja e mëparshme, se si melekët i afroheshin tokës për të dëgjuar dhikrin (përmendjen) nga përmendësi, ndërkohë që ai me to thërriste Zotin e tij, e na kthen te ndikimi shpirtëror i Muhammedit në sahabët e tij!

Gjithë universi, jo vetëm toka, mishërohet me zërat e myezinëve, që thërrasin njerëzimi të nxitojnë drejt kënaqësisë së Allahut! Nuk është për tu habitur, që prej dëgjuesit të ezanit është e kërkuar, ndërkohë që jehona e ezanit vazhdon të tingëllojë në veshët e tij, të lutet për njeriun e madh, i cili i udhëzon ata drejt Allahut dhe u prin në siratul-mustekim (rrugën e drejtë!

Një sahabij e mohoi veten e tij kur ndjeu dallimin e madh mes gjendjes së tij me të Dërguarin e Allahut dhe gjendjes së tij, pasi përzihej me familjen dhe lodhej me shqetësimet e kërkimit të rrizkut. Ai mendoi se kishte bërë hipokrizi me këtë ndryshim. Ai me të Dërguarin e Allahut, ishte zemërndriçuar, vërtitej në pozitat e perfeksionit, sikur e shikonte Zotin e tij dhe e ndjente Madhështinë e Tij! Derisa, kur kthehej në shtëpi, në rrugë, tek familja dhe tek njerëzit e lëshonte veten dhe turbullohej! Pejgamberi (a.s) i tha: "Nëse do të qëndronit në këtë gjendje tuajën me mua, do t''ju kishin takuar me duar melekët, por sahata, sahata".

Shumë prej sahabëve qëndronin gjatë në orët e dritësimit, të cilat i bashkonte i zoti i mesazhit të madh dhe triumfonin shpesh ndaj natyrës njerëzore, shqetësimeve të jetës dhe hijeve njerëzore. Në sunet ka ardhue se, Ebu Umejr transmeton nga një prej xhaxhallarëve të ti nga ensarët, se i Dërguari i Allahut u interesua shumë për namazin, si t'i tubojë njerëzit në të? Dikush tha: Të valëvitet një flamur kur hynë koha e namazit, e kur ta shohin, lajmërojnë njëri-tjetrin. Kjo nuk e tërhoqi dhe i kujtuan borinë (bririn) e hebrejve, që i fryhej për të lajmëruar për faljen e tyre. Edhe kjo nuk e tërhoqi dhe tha: "Kjo i përket jehudive". Dikush i kujtoi kambanën, por ai tha: "Kjo i përket të krishterëve". Abdullah ibn Zejd El-Ensariu u largua dhe ai ishte i preokupuar për shqetësimin e Pejgamberit (a.s), e iu shfaq në ëndërr.

Në transmetim tjetër të hollësishëm, transmetuesi tregon se një ensar shkoi dhe i tha: O i Dërguar i Allahut, unë kur u ktheva në shtëpi dhe pasi vura re shqetësimin tënd, pashë një njeri me dy palë rroba të gjelbërta. U ngrit në këmbë në xhami dhe thirri ezanin, pastaj u ul pak dhe u ngrit përsëri dhe tha të njëjtën gjë, përveçse ai thoshte: "Kad kametis-salah" (filloi falja e namazit). Sikur të mos flasin njerëzit, do të kisha thënë se, isha zgjuar dhe jo në gjumë. I Dërguari i Allahut tha: "Allahu të ka shfaqur diçka të mirë, prandaj urdhëro Bilalin të thërrasë ezanin". Umer ibnul-Khatabi tha: Edhe unë e kam parë atë, të cilën ai ka parë, por kur pashë se ai foli para meje, pata turp. Tha për të: Meleku, të cilën e pa Umeri u soll nga kibla dhe tha: "Allahu Ekber, Allahu Ekber" dy herë, "Eshhedu el-la ilahe il'lall-llah" dy herë, "Eshhedu enne Muhammeden Resulull-llah" dy herë, "Hajja ales-salah" dy herë, "Hajja alel-felah" dy herë, "Allahu Ekber, Allahu Ekber, La ilahe il'lall-llah", pastaj pushoi një copë herë, më pas u ngrit përsëri në këmbë dhe tha të njëjtën gjë, përveçse shtoi pas "Hajja alel-felah": "Kad kametis-salah, kad kametis-salah". I Dërguari i Allahut (a.s) tha: "Thuaja Bilalit", e Bilali thirri me to; Bilali ka qenë zëbukur dhe muezin i mirë.

Transmetimet dallojnë nga njëri-tjetri me dallime të vogla në disa fjalë, por me përputhjen e të gjithave në origjinën e kësaj ngjarjeje dhe burimin e marrjes.

Ndërkohë që, zhvishem prej ndikimit të asaj që transmetohet, më gjen duke anuar nga dëgjimi i ezanit dhe pasimin e fjalëve të tij që qeta, sepse unë kam dëshirë të udhëhiqem nga mendja dhe jo nga veshi! Ezani më zgjon zemrën time dhe më njeh me Zotin tim në atë mënyrë që harmonizohet me natyrën e shëndoshë. Prej këtu mësojmë, se feja ka pëlqyer për dëgjuesit e ezanit, t'i përsërisin fjalët e tij dhe t'i ngulisë në ndjenjat e tyre.

Ebu Hurejra (r.a) tregon se: Ishim me të Dërguarin e Allahut (a.s), ndërkohë Bilali u ngrit dhe thirri ezanin për namaz, e kur mbaroi, Pejgamberi (a.s) tha: "Kush thotë sikur ky, me bindje, ka hyrë në xhenet".

Nuk di ndonjë fjalë tjetër, që meriton të dëgjohet dhe ia vlen të meditohet në të, se sa fjalët e ezanit. Dhe, nuk gjej ndonjë thirrës tjetër, që të thërrasë në udhëzim, se sa myezini. Fjalët me zë të lartë që ushtojnë në horizonte të përkujtojnë Allahun dhe të drejtat e Tij, të kujtojnë punën për të hirë të së cilës jemi krijuar.

Sead inb Ebi Vekasi transmeton se, i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Kush thotë kur dëgjon muezinin: Edhe unë dëshmoj se, nuk ka zot tjetër, përveç Allahut, i Vetëm dhe i pa shoq, dhe se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij. Jam i kënaqur që Allahun kam për Zot, Muhammedin për të dërguar, Islamin për fe, Allahu ia ka falë gjynahun e tij". Gjithashtu, Xhabiri tregon se, i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Kush thotë kur dëgjon thirrjen (ezanin): O Zot i kësaj thirrjeje të plotë dhe i namazit që po falet, jepi Muhammedit lidhjen dhe mirësinë dhe ringjalle o Allah Muhammedin në pozitën, të cilën ia ke premtuar, përveçse ai e ka merituar shefaatin (ndërmjetësimin)".

Kur njeriu mediton në fjalët e ezanit, gjen se ato janë ajka e shpalljeve qiellore dhe përshkrim i Allahut, që ekziston në saj të vërtetës absolute, të vërtetës e cila nuk ndryshon nga lindja në perëndim!

Çfarë ka pas tekbirit (madhërimit) të Allahut, njësimit (teuhidit) dhe thirrjes së përhershme për adhurim të Tij?

Kjo është një thirrje që qarkullon mbi sipërfaqen e tokës, duke përshkuar meridianët e gjatësisë mbi dete dhe tokë, shoqërues e tokës në lëvizjen e saj rreth nënës së vet, diellit. Dhe, detyra e madhe e Muhammedit është zbatimi i urdhrit që ka dalë për të: "Lavdëroje (bëji tesbih) me falënderim Zotit tënd, përpara lindjes së diellit dhe përpara perëndimit të tij. Edhe natën lavdëroje (bëji tesbih) dhe skajeve të ditës, ndoshta ti kënaqesh". (TaHa: 130)

Gjithë universi, jo vetëm toka, mishërohet me zërat e muezinëve, që thërrasin njerëzimi të nxitojnë drejt kënaqësisë së Allahut! Nuk është për tu habitur, që prej dëgjuesit të ezanit është e kërkuar, ndërkohë që jehona e ezanit vazhdon të tingëllojë në veshët e tij, të lutet për njeriun e madh, i cili i udhëzon ata drejt Allahut dhe u prin në siratul-mustekim (rrugën e drejtë! Pasha Allahun, nuk ka dyshim se e meriton të lutemi përherë, që Allahu t'ia lartësojë gradën e tij e ta shpërblejë me të mira për hatër të myslimanëve.

Megjithatë, ëndrrat e njerëzve, sado që gjendja e tyre të jetë e përkushtuar, nuk janë burim i shpalljes e as argument, sikur të mos ta kishte miratuar Pejgamberi (a.s) dhe të mos e kishte urdhëruar që të punohet me të, sa herë që kërkohet të punohet me të! Ndoshta, Allahu ka pasur për qëllim qetësinë e Pejgamberit të Tij, se mesazhi i tij ka korrur sukses në formimin e një brezi me faqe të pastër e rrugë të dëlirë, takohen me krijesat e larta, dëgjojnë prej tyre dhe transmetojnë prej tyre. E thamë në përgjigjen e mësipërme, se melekët zbresin ndër besimtarët e drejtë e i frymëzojnë udhëzim, i mbështesin në të vërtetën dhe në zemrat e tyre u hedhin përgëzime: "Ata, të cilët thanë: Zoti ynë është Allahu, pastaj ecën në rrugën e drejtë, mbi ta zbresin melekët, që të mos frikësoheni e të mos hidhëroheni..." – (Fussilet: 30)

Por, dera e iluzioneve dhe e pretendimeve, patjetër që duhet mbyllur, sepse nuk pranohet asnjë fjalë prej botës së gajbit (të fshehtë), përveçse vetëm nga i pagabuari ! Myslimanët janë të gjithë në konsensus, se Sheriati nuk ka burim tjetër, veçse Librin dhe Sunetin. Ndërkohë, në kohën tonë janë shfaqur bujq, që i kanë hyrë fushës fetare dhe kanë pretenduar se u vjen shpallje, por ilaçi më i mirë për ta është të dërgohen në spitalet e sëmundjeve mendore për marrje e tij!

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

KUR'ANI, LIBRI I JETËS

Hasan Baftijari
teolog, Shkup

Me të vërtetë Kur'ani është libri i jetës me norma dhe principe bindëse e praktike, të punës, moralit dhe bashkësisë. Ai është burim gjallërues, shërues dhe këshillues për ata të cilët janë gjallë. Këtë, vet surja Jasin e thotë kështu: "Ai (Kur'ani) nuk është tjetër, vetëm se këshillë dhe Kur'an i qartë. Për t'ia tërhequr vërejtjen atij që është gjallë (me mend e zemër) dhe dënimi të bëhet meritë për jobesimtarët".

Kur'ani, mrekullia e përhershme e Zotit të Plotëfuqishëm, i ka zbritur Profetit të nderuar të Islamit në periudha dhe kohëra të ndryshme sipas nevojës së njerëzimit. Ajetet e thella të Kur'anit ashtu siç tërhiqnin zemrat drejt vetes, ashtu e pastronin pluhurin e paditurisë (xhahilietit) dhe njerëzit i njihnin me mëshirën dhe të mirën. Shumica dëshirojnë të njihen me shkaqet e shpalljes se ajeteve Kur'anore dhe të informohen me ngjarjet të cilat u bënë shkak i shpalljes së ajeteve në sfera të ndryshme.

Sot, mediat në botë me propagandat e tyre të shumta përpiqen të prishin pamjen e Islamit dhe ta paraqesin Kur'anin, si një libër të vjetër. Fuqitë e mëdha duke përdorur mjetet më moderne, përpiqen të dobësojnë myslimanët dhe njëkohësisht mundohen të ulin ndikimin dhe përhapjen e Islamit në botë. Në këtë mes, ne shikojmë se Kur'ani i Shenjtë duke qënë se është një dritë e madhe e Zotit të Vetëm, në mënyrë shumë të qartë paraqet të vërtetën e tij. Kur'ani është libri i shenjtë më i miri dhe më i ploti. Ai tërheq mbas vetes mendjet dhe kjo është vetëm një nga veçoritë e tij. Kur'ani është një udhëzues që të fton për tek e vërteta, një libër lutjesh e përmendje të shpeshta të Krijuesit, emrit të Zotit. Ai ka karakter konstruktiv, sepse ndikon mbi botën ndjesore të njeriut. Kur'ani ndërron dhe rregullon vlerësimin e gabuar të njerëzimit të zhytur në errësirën e mohimit dhe herezisë mbi gjithësinë, jetën dhe njeriun, duke realizuar kështu transformimin më të madh.

Një kusht për kuptimin e Kur'anit është ta studiosh atë me mendje të hapur. Pavarësisht nëse dikush beson apo jo që ai është një libër i shpallur, ai duhet që sa me shumë të jetë e mundur ta çlirojë mendjen e tij nga animi pro ose kundër tij, ta çlirojë nga të gjitha opinionet paraprake dhe më pas t'i qaset atij me dëshirën e vetme për ta kuptuar atë.

Kanadezi Gary Miller është pedagog në universitet. Ai për vite ka ndjekur doktrinën krishtere dhe ka qënë një aktivist i palodhshëm. Ai kishte një dëshirë të madhe për çështjet mendore. Ai në fillim mendonte se Kur'ani, i cili ka zbritur 14 shekuj më parë, kishte të bënte vetëm me çështjet e së kaluarës. Më pas me shtimin e valës së Islamit në perëndim, ai mori vendimin që të studionte Kur'anin me qëllim që të gjente gabimet e Kuranit dhe ta bënte atë të papranueshëm.

Ai thotë: Atë ditë fillova të lexoja Kur'anin për të gjetur gabimet e tij, në mënyrë që të lartësoja pozicionin e krishterëve përballë myslimanëve. Duke qënë se mendoja, që Kur'ani i cili ka zbritur 14 shekuj më parë në shkretëtirë do të ishte plot gabime. Por sa më shumë që e lexoja, vëreja të vërteta të cilat më habisnin. Pa e besuar kuptova se në këtë libër të shenjtë nuk ka gabime. Përveç kësaj, kuptova se në Kur'an janë shtruar çështje të shumta mbi të cilat nuk flitet në ndonjë libër tjetër të shenjte. Ky libër më bëri kurioz dhe për këtë mora vendim ta lexoja më me përpikmëri. Kur arrita tek ajeti 82 i sures Nisa u habita shumë. Në këtë ajet theksohet: "A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie".

Siguristh që kjo nuk është hera e parë që një jo mysliman flet për madhështinë, aktualitetin dhe të vërtetën e Kur'anit. Kur'ani i madhërishëm është një oqean i pafund, ku askush nuk mund të gjejë dhe diskutojë kufijtë e tij. Ky libër është pasqyra e jetës dhe nga thellësia dhe gjerësia e tij nuk ka limit. 14 shekuj më parë, dijetarë dhe mendimtarë të shumtë kanë lundruar në këtë oqean pa fund. Por asnjëri prej tyre nuk ka mundur të gjejë sekretin e tij. Ata gjithashtu falen tek Zoti me madhështi duke qënë përkrah Kur'anit. Në ajetin e parë të sures Furkan theksohet: "Ai që ia shpalli Furkanin (Kur'anin, dallues të së vërtetës nga e pavërteta) robit të vet (Muhamedit) që të bëhet pejgamber i botës (këshillues), është i madhëruar".

Sejjid Kutb komentues dhe dijetar egjiptian thotë: "Një ditë së bashku me 5 shokë me një anije egjiptiane e kalonim oqeanin në drejtim të perëndimit. Udhëtarët ishin 120 burra dhe gra, ku përveç nesh, nuk ishte askush mysliman. Ditën e xhuma na u kujtua që në mes të oqeanit të falim namazin e xhumasë dhe në këtë mënyrë të jemi edhe predikues të fesë dhe mësimeve të pastra të Islamit. U bëmë gati për namaz dhe unë fillova të lexoj hytbet e namazit të së xhumasë. Udhëtarët jomysliman ishin mbledhur përreth nesh dhe me kujdes shikonin atë që bënim ne".

Sejjid Kutb në vazhdim thekson: "Pas përfundimit të namazit shumë prej tyre erdhën tek ne dhe parashtruan shumë pyetje në lidhje me Islamin, namazin dhe çështje tjera. Në mesin e këtyre njerëzve, një grua e krishterë nga Jugosllavia ishte impresionuar shumë nga namazi ynë në mënyrë që nga sytë i pikonin lotët. Unë u habita nga ndjenja e sajë. Ajo grua në gjuhën angleze më pyeti: Ju në çfarë gjuhe flisni?

I shpjegova asaj se namazi është një program Islam, që duhet patjetër të kryhet në gjuhën arabe.

Ajo tha: "Megjithëse unë nuk e di gjuhën arabe, por në mes të thënieve tuaja kishte fjali me rritëm jashtëzakonisht ndikues të thellë, sa që ndikuan në mua pa dëshirën time. Tingujt e atyre fjalive akoma janë në veshët e mi, thuajse janë dedikuar për shpirtin tim".

Sejjid Kutb thotë: "Unë mendova pak dhe kuptova se fjalitë, që kishin entuziazmuar këtë grua të krishtere janë ajetet, të cilët unë i lexova gjatë hytbes dhe namazit. Kjo çështje më habiti mua dhe më kujtoi këtë të vërtetë se mrekullia e ajeteve të Kur'anit është e atille sa që ritmi i tij entuziazmon, ndikon dhe sjell ndryshime edhe tek persona, të cilët nuk janë të njohur me gjuhën e Kur'anit. Ky ishte një realitet të cilin ne e pamë me sytë tanë.

Një tjetër e veçantë interesante që ekziston në Kur'an është se Kur'ani vazhdimisht merret me këshillat, që ai i ofron lexuesit. Kur'ani e informon lexuesin për fakte të ndryshme dhe më pas këshillon, "nëse kërkon të dish më tepër për këtë ose atë, apo nëse dyshon në atë qe thuhet, atëherë pyet ata që kane dituri". Kjo është një tjetër karakteristikë që të ngjallë habi. Nuk është normale për dikë që nuk ka eksperiencë në gjeografi, botanikë, biologji, etj, të diskutojë për këto tema, dhe më pas të këshillojë të tjerët të pyesin ata që kanë dituri nëse informacioni është i dyshueshëm. Gjatë të gjitha kohërave, shumë muslimanë kanë ndjekur këshillat e Kur'anit dhe kanë bërë zbulime të shumta. Nëse do të hidhnim një sy mbi punën e shkencëtarëve muslimanë të shumë shekujve më parë, do të shikonim që ata kanë përdorur shpesh kuota nga Kur'ani. Punët e tyre tregojnë që ata bënë studime në një vend të caktuar, sepse ata kërkonin të arrinin diku. Dhe ata do të na siguronin që arsyeja që i bëri ata të studionin mbi diçka të tillë, ishte sepse Kur'ani i tregoi atyre drejtimin e duhur. Për shembull, Kur'ani flet për origjinën e njeriut dhe më pas i thotë lexuesit: "Bëj kërkim mbi të". Ai i jep lexuesit një shenjë dhe më pas thotë që ka akoma diçka për të zbuluar. Kjo është ajo mbi te cilën muslimanët nuk tregojnë interes.

Një prej veçorive më të rëndësishme të Kur'anit është përsëritja. Më shumë se në temat e tjera, në Kur'an, përsëritja ndihet tek rrëfimet. Në të vërtetë, kjo nuk është thjeshtë një përsëritje e zakonshme. Ajo është një model stilistik, i cili brenda atmosferës së përgjithshme të sures (kapitullit), me anën e parantezave e të kthimeve, përmban për çdo radhë, pra, kur rimerret diçka, hollësi të veçanta. Kështu secili detaj, si simbol i një mësimi të caktuar, u hap zemrave një mijë e një dritare sublime për të parë drejt botëve të fshehta.

Edhe një veçori që bie në sy në rrëfimet e Kur'anit është edhe kjo: Kur'ani merr nga ndodhia që përcjellë, vetëm atë pjesë që përmban qëllimin, të cilin e merr si shembull. Meqë i jep rëndësi nënvizimit të qëllimit fetar të ndodhisë në fjalë, Kur'ani e rrëfen ndodhinë që nga kreu, mesi ose fundi, pa marrë parasysh rrjedhën historike. Kur'ani nuk e lë lexuesin të humbë mes ndodhive të rrëfimit, me anë të rrëfimit ai ka paraqitur udhëzime fetare, që i japin blerim klimës së zemrës. Rrëfimet e Kur'anit nisin me një hyrje tërheqëse për lexuesin. Ndodhitë nuk radhiten me shprehje të thata, por paraqiten të konkretizuara me anë të një përshkrimi plot lëvizje e gjallëri. Me përsëritjen e ideve, ku disa herë jepen hollësi e disa herë jepen përmbledhje, ai u drejtohet niveleve dhe mendësive të ndryshme. Ka njerëz që u mjafton një përsëritje e shkurtër, disa të tjerëve u duhen hollësi. Përsëritja, veç qëllimit përforcues, siguron edhe njërin nga detajet e stilistikës së kumtimit, sikurse janë shkaktimi i mahnitjes nga tmerri, frikësimi dhe paralajmërimi nëpërmjet ngjalljes së përfytyrimeve.

Duke pasur parasysh veçoritë e posaçme të Kur'anit, z. Hashemi Rafsanxhani, kryetari i këshillit për mbrojtjen e interesave të RII, në ceremoninë e hapjes së panairit të 12-të të Kur'anit vuri theksin në këtë çështje

> "Ai (Kur'ani) nuk është tjetër, vetëm se këshillë dhe Kur'an i qartë. Për t'ia tërhequr vërejtjen atij që është gjallë (me mend e zemër) dhe dënimi të bëhet meritë për jobesimtarët"

dhe theksoi: "Sot, njeriu ka nevojë për një shkollë fetare. Asnjë mrekulli nuk është më e lartë se Kur'ani dhe asnjë predikim nuk është më me ndikim se Kur'ani. Duke pasur parasysh numrin e madh të muslimanëve, ekziston mundësia që dituritë fetare dhe mësimet kur'anore të jenë udhërrëfyese në botë. Është e nevojshme që qeveritë, personalitetet dhe mendimtarët islamë të gjejnë ndonjë rrugë për të shfrytëzuar si duhet Kur'anin në shoqëritë njerëzore. Kur'ani nuk lejon që mendjemadhësia që vjen si pasojë e fuqisë, ta largojë poseduesin e sajë nga rruga e drejtë dhe plotëson në mënyrën më të mirë dëshirat e shoqërive njerëzore".

Kur'ani tërheq vëmendjen për thelbin e ndodhive. Çdo ajet i Kur'anit të Famëlartë i fton njerëzit që t'i largohen rrugës së veseve, poshtërsive dhe të bëhen njerëz të denjë për familjen e tyre, por edhe për të tjerët. Besimtarët që duan të arrijnë lumturinë e kësaj bote e të përjetësisë, janë të detyruar t'i përdorin jetën, pasurinë dhe të gjitha dhuntitë që u ka falur Allahu (xh.sh), për synime dhe qëllime serioze. Kur lexohet Kur'ani, nga qielli bie shiu i mëshirës dhe bereqetit Hyjnor mbi shpirtin e njeriut. Por leximi I Kur'anit duhet të jetë me ide dhe logjikë, sepse Kur'ani është kënga më e bukur e jetës dhe përjetësisë. Sado që përparon dija dhe shkenca e njerëzimit, njeriut i paraqiten pamje dhe kënde të reja nga ky dokument qiellor.

Kur'ani është burimi i dritës, mëshirës dhe behari i zemrave. Kjo mrekulli e madhe e Profetit është fjala e shpalljes Hyjnore, e cila me ligjet humane dhe të plota, e çon njeriun drejt së vërtetës. Kur'ani është si një lum që rrjedh nëpër kohë dhe çdokush që e shfrytëzon atë, fiton jetë dhe lumturi. Ajetet e Kur'anit tregojnë se ky libër është me logjikë të pavdekshme dhe me aspektet më të larta të mirësisë në të cilin nuk gjendet asnjë shtrembërim. Është udhërrëfyes, dhe kalimi i kohës jo vetëm që nuk e vjetron atë, por qartëson edhe me tepër shtimin e diturisë së njeriut dhe zbulon mësimet e fshehura të tij.

Por, me gjithë ndihmën e këtyre mjeteve, dikush nuk mund ta kapë shpirtin frymëzues të Kur'anit vetëm në qoftë se ai fillon ta vendojë në praktikë mesazhin e tij, sepse Kur'ani nuk është një libër idesh dhe teorish abstrakte, të cilat mund të studiohen lehtësisht i ulur në karrige, as një libër i enigmave religjioze, të cilat mund të zgjidhen vetëm në universitete dhe manastire. Ai është një libër, i cili është dërguar për të ftuar njerëzit drejt fillimit të një lëvizjeje dhe për të udhëhequr aktivitetet e tyre drejt arritjes së misionit të tij.

Dikush duhet, në këtë mënyrë, të shkojë në fushëbetejën e jetës për të kuptuar kuptimin e tij real. Në këtë mënyrë është afërmendsh, që dikush nuk mund ta kuptojë të vërtetën që përmban Kur'ani, thjesht me leximin e fjalëve të tij. Për këtë qëllim ai duhet të marrë pjesë aktive në konfliktin ndërmjet besimit dhe pabesimit, Islamit dhe joislamit, të vërtetës dhe të pavërtetës. Dikush mund ta kuptojë atë vetëm nëse ai kupton mesazhin e tij, fton botën ta kuptojë atë dhe vepron sipas udhëzimeve të tij.

ARABIA SAUDITE

"Vërtetë, faltorja e parë që është vënë në tokë për njerëzit, është ajo në Bekke (Mekë), e bekuar dhe udhëzim për mbarë botët." – (Kur'ani, Ali Imran: 96)
"Zoti e ka bërë të shenjtë Mekën që ditën që Ai i krijoi qiejt dhe tokën, prandaj ajo është e shenjtë me shenjtërinë e Zotit deri në Ditën e Ringjalljes." – (Buhariu)

Sa herë dëgjojmë për Arabinë Saudite, menjëherë mendja na shkon tek Meka e Bekuar dhe tek Medina e Ndritur, dy vende që Zoti i Madhërishëm i ka shenjtëruar e i ka lartësuar mbi të gjitha vendet e botës.

Por, cila është Arabia Saudite? Le të flasim pak për këtë vend të bekuar.

POZITA E SAJ GJEOGRAFIKE DHE NUMRI I POPULLSISË:

Mbretëria e Arabisë Saudite shtrihet në jug-perëndim të kontinentit të Azisë. Ajo kufizohet me Mbretërinë Hashimite të Jordanisë dhe Republikën e Irakut në veri; me shtetin e Kuvajtit në verilindje; në lindje kufizohet nga Gjiri i Arabisë, Mbretëria e Bahreinit, Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe; në juglindje kufizohet me Sulltanatin e Omanit; në jug kufizohet me Republikën e Jemenit, ndërsa në perëndim, ajo kufizohet me Detin e Kuq.

Arabia Saudite zë pjesën më të madhe të Gadishullit Arabik (katër të pestat e tij), me një sipërfaqe prej më shumë se 2.250.000 km2.

Relievi i saj përbëhet nga fusha të ngushta në bregun e Detit të Kuq (rrafshinat e Tihamës), pastaj në lindje, vijnë zinxhirët malorë, malet e Hixhazit dhe malet Asir, të cilat shtrihen përgjatë vendit e lartësia e tyre maksimale i kalon 2000 metra mbi nivelin e detit. Në pjesën qendrore të vendit gjenden shkretëtira dhe relieve të ngritura shkëmbore (90% e sipërfaqes totale), ku më e madhja është shkretëtira Sahra En-Nafuudh në veri, dhe Sahra Rub'al Hali në jug. Në lindje, dhe përgjatë gjithë bregut të Gjirit të Arabisë, shtrihen fusha bregdetare të gjëra.

Popullsia e Mbretërisë së Arabisë Saudite, sipas rezultateve të statistikave të popullsisë në vitin 2017, ka qenë 32,552,336 banorë[1].

INDUSTRIA:

Industria në Arabinë Saudite është e lidhur me naftën dhe gazin natyror, rafinimi dhe petrokimikët. Produktet më të rëndësishme industriale janë: çimentoja, katrani, shufrat e çelikut, etileniti, glikol etileni, etanoli industrial, melamina, etj. Arabia Saudite e ka të zhvilluar industrinë ushqimore, si dhe teknologjinë për pastrimin e ujit të detit nga kripa, ku çdo vit merren rreth 100 milion metra katror ujë deti. Kjo sasi uji është shumë pak në krahasim me 9,500 milionë metra kub ujë të furnizuara çdo vit nga ujërat nëntokësore, të cilat konsumohen nga bujqësia. Sot, Mbretëria e Arabisë Saudite po dëshmon një rritje të ndjeshme në industrinë agro-ushqimore dhe në industrinë e mallrave të konsumit, të cilat mbështeten mbi kapitalin privat[2].

PAK NGA HISTORIA E KËTIJ VENDI...

Rrënjët e Arabisë Saudite datojnë qysh nga qytetërimet e para që u shfaqën në Gadishullin Arabik. Gadishulli Arabik gëzon një vend strategjik midis tre kontinenteve të mëdha dhe gjendet në hemisferën veriore të globit. Ai është vatani i shumë qytetërimeve dhe djepi i mesazheve qiellore dhe i të dërguarve të Zotit, paqja qoftë mbi ta!

Brenda kufijve të mbretërisë, ka lulëzuar qytetërimi i Medjenit, vendi i popullit të Profetit Shuajb (a.s), atje ku Profeti Musai (a.s) jetoi dhjetë vjet nga jeta e tij, para se të dërgohej nga Zoti për tek Faraoni i Egjiptit. Në zonën e sipërme të Arabisë Saudite, dikur ndodhej qytetërimi i popullit Themud, ku u dërgua Profeti Salih (a.s). Gjurmët e atij populli janë ende të pranishme edhe sot në zonën e njohur si "Medain Salih". Ndërsa në Nexhran, gjejmë "Uhdudët" (hendeqet),të përmendur në Kur'an si "Ata të Uhdudëve".

Në këtë gadishull, i cili ishte një korridor i rëndësishëm tregtar dhe një rrugë për karvanet, Zoti i Lartmadhërishëm zgjodhi Profetin e fundit, Profetin Muhammed, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, të cilit i zbriti fjalën e tij, Kur'anin Famëlartë. Mësimet e Islamit u përhapen në zemrën e Gadishullit Arabik dhe që aty u dërguan në të gjitha anët e botës, derisa mbërritën në Afrikë, Azi dhe në një pjesë të Evropës. Që atëherë, bota islame ka njohur lulëzim të madh përgjatë epokave të ndryshme.

Mjafton si nderim për Arabinë Saudite, që aty ndodhen vendet e shenjta, Meka e Nderuar dhe Medina e Ndritur.

MEKA E BEKUAR

Meka e nderuar gjendet në perëndim të Mbretërisë së Arabisë Saudite, në një zone të thatë malore, që është e papërshtatshme për rritjen e pemëve apo të bimëve. Meka shtrihet në perëndim të Gadishullit Arabik, 80 km nga Deti i Kuq. Ajo është një zonë kryesisht shkëmbore, me male të thata dhe lugina që janë të mbuluara nga depozitat e zhavorrit dhe rërës.

Qyteti i Mekës arrin një sipërfaqe prej rreth 850 kilometra katrorë, dhe ka një lartësi rreth 277 metrash mbi nivelin e detit. Qyteti i shenjtë pret vizitorë gjatë gjithë vitit, të cilët vijnë aty për të kryer dy detyra: Haxhin dhe Umren, gjë e cila bën që numri i popullsisë aty të shumëfishohet.

Meka e nderuar gjithmonë ka qenë stacioni i karvanëve që udhëtonin mes veriut dhe jugut në kohët e para Islamit, duke mbajtur kështu në dorë frenat e tregtisë në mes Gadishullit Arabik dhe dy palëve konkurruese të asaj kohe, persianëve dhe romakëve. Kështu, Meka lulëzoi për shkak të tregjeve komerciale të famshme të asaj kohe që gjendeshin aty, tregu i Ukadhit, tregu i Mexhennes, dhe tregu i Dhil Mexhaz, ku zhvilloheshin edhe forume letrare sezonale. Kjo u mundësoi njerëzve të saj të arrinin pasuri të mëdha nga tregtia, e cila ua kompensoi varfërinë e mjedisit që i rrethonte. Ekonomia në Mekë sot, varet kryesisht nga sezonet fetare dhe shpenzimet qeveritare. Sezoni i Haxhit dhe i Umres përbën burimin kryesor të të ardhurave për banorët e atij vendi.

Historia e themelimit të Mekës daton para lindjes së Profetit Ismail dhe babait të tij, Profetit Ibrahim, paqja qoftë mbi ta, të cilët i ringritën themelet e Qabes. Qysh më përpara, Meka ka qenë e banuar nga pasardhësit e Profetit Ademit, paqja qoftë mbi të, derisa ai vendbanim, sipas dijetarëve, u shkatërrua nga përmbytja që goditi tokën në epokën e profetit Nuh (a.s). Më pas kësaj, ajo zonë u kthye në një luginë të thatë, e rrethuar me male të thata nga çdo anë.

I Lartmadhërishmi thotë në Kur'anin Famëlartë: "Vërtetë, Faltorja e parë e vënë në tokë për njerëzit, është ajo në

Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhëzim për popujt. Në të ka shenja të qarta, aty është Mekami i Ibrahimit; kush hyn në të është i sigurt. Për hir të Zotit, njerëzit e kanë detyrë ta vizitojnë këtë Faltore (Haxhi), kush ka mundësi ta përballojë rrugën, e kush mohon, Allahu nuk ka nevojë për askënd në botë." – (Kur'ani, Ali Imran: 96-97)

Meka, është qyteti, ndërsa Bekke, është vendi ku ndodhet Faltorja - Qabeja. Shenjat e qarta, siç thonë dijetarët, përveç Mekamit të Ibrahimit (a.s), janë edhe Guri i Zi, Guri i Ismailit, burimi Zemzem, dhe gjithë simbolet e tjera të shenjta.... Zogjtë nuk fluturojnë kurrë sipër Qabes, ndërsa kafshët grabitqare, kur janë në ndjekje të presë së tyre, e preja hyn në zonën e Qabesë, kafsha grabitqare ndalon dhe nuk e gjurmon më tej. Atë vend e kanë vizituar profetët dhe të dërguarit e Zotit gjatë gjithë kohërave, kurse puna e mirë në atë vend e ka shpërblimin të shumëfishtë.

Për Mekamin e Ibrahimit (a.s), tregohet se pasi Ibrahimi (a.s) mbaroi së ndërtuari Qabenë e Nderuar, ai qëndroi mbi gur, dhe këmbët e tij "u zhytën" në të duke lënë aty gjurmë të përjetshme, në kujtim të punës së tij. Ky gur me gjurmët e këmbëve të tij, ka qëndruar shekuj me radhë ngjitur me Qabenë e Nderuar, si një shenjë dalluese e Shtëpisë së Shenjtë të Zotit në Mekën e Nderuar.

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Dherr, thuhet se i ai e kishte pyetur të Dërguarin e Zotit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të: Cila është faltorja e parë e vënë në tokë? I Dërguari i Zotit i tha: Mesxhidul-Haram (Faltorja e Shenjtë).

Ebu Dher pyeti prapë: Po pas saj?

I Dërguari i Allahut i tha: Mesxhidi Aksa (Faltorja e Largët, në Palestinë).

Unë i thashë: Sa kohë ka mes tyre? - tregon Ebu Dherr.

Ai tha: Katërdhjetë vjet, pastaj, gjithë toka është për ty faltore, e kudo qofsh, kur vjen koha e namazit, aty falu!" (Muslimi)

***

Ibrahimi (a.s) ishte i pari që i vendosi aty gruan e tij Haxherin (r.a), bashkë me djalin e tij të vetëm në atë kohë, Ismailin (a.s), që të banonin në atë vend që atë kohë ishte krejtësisht i shkretë.

Zoti i Madhërishëm e kishte urdhëruar Ibrahimin të vepronte kështu, pasi aty gjendej Shtëpia e Tij e Shenjtë, e cila tani ndodhej e mbuluar nga rëra, për shkak të përmbytjes së madhe që nga koha e Nuhit (a.s).

Ibrahimi (a.s) pati bërë këtë lutje kur i vendosi të banonin aty familjen e tij: "O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi, në një luginë pa bimë, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë." – (Kur'ani, Ibrahim: 37)

Pastaj, kur Ismaili (a.s) u rrit, Zoti i plotfuqishëm e urdhëroi Ibrahimin (a.s) që bashkë me të birin, ta rindërtonin Shtëpinë e Shenjtë.

Ata të dy e kryen detyrën në mënyrën më të mirë, pastaj Zoti i Plotfuqishëm e urdhëroi Ibrahimin (a.s): "Thirri njerëzit për haxhillëk: Ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta..." – (Kur'ani, El Haxh: 27)

Dhe që nga ajo kohë e deri sot, njerëzit nuk kanë pushuar së vizituari atë vend të shenjtë.

***

I Dërguari i Zotit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ditën e Haxhit të Lamtumirës, pati thënë: "Zoti e ka bërë të shenjtë Mekën që ditën që Ai i krijoi qiejt edhe tokën, prandaj ajo është e shenjtë me shenjtërinë e Zotit deri në Ditën e Ringjalljes. Ajo ka qenë e shenjtë dhe nuk i është lejuar askujt para meje, as nuk i lejohet kujt pas meje ta prekë shenjtërinë e saj...Nuk më është lejuar as mua, përveç një orë të kohës... prandaj nuk lejohet të trembet gjahu i saj, nuk priten ferrat e saj, nuk pritet bari i saj dhe nuk lejohet të merret gjëja e gjetur aty, përveç nëse e njeh." – (Buhariu)

Vazhdon në numrin e ardhshëm me tregimin për Medinën e Ndritur...

Përgatiti:
Arta Ujkaj, *teologe*

1. (https://www.stats.gov.sa/ar/indicators/1)

2. (http://www.mofa.gov.sa/aboutKingDom.old/Pages/KingdomGeography37.aspx)

"EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)" - DR. MUHAMMED A. JEMANI

*(LIBËR I PËRKTHYER NGA **H. VEHBI S. GAVOÇI** - SHKODËR, 1996)*

EMIGRIMI PROFETIT (A.S)

Emigrimi njihet në historinë tonë islame si fitorja e trimit.

Zbritja e Kur'anit ka qenë ngjarja më e parë dhe më interesantja që ka ndodhur në histori, ndërsa emigrimi ka qenë pa dyshim ngjarja e dytë më interesante. Me emigrimin triumfoi Islami dhe myslimanët u qetësuan, vunë gurin e parë të qeverisë islame. Kështu Islami, mbasi ishte në fillim besim e mendim, kaloi në zbatim e në veprim. Në këtë mënyrë u formua një bashkësi (komunitet), ku zbatoheshin urdhrat e Zoti, ku spikatnin shpirti, rregulli, statuti dhe sjelljet morale e karakteri i mirë.[1]

Emigrimi ishte një fitore nga Zoti (xh.sh) në ndihmë të fesë islame, madje qe parashikim për fitoret e tjera më të mëdha, që u vërtetuan në luftën e Hunejnit e në luftëra të tjera.

Sikur të mos ishte emigrimi, nuk do të kishte kalendar me të cilin caktojmë datën, ditën, muajin e vitin. Arabët para misionit të Profetit (a.s) përdornin ndodhitë e mëdha si data orientuese. P.sh, kishin si datë luftën e Fixharit dhe thonin: një vit përpara ose prapa. Po ashtu marrëveshja e Hilful-Fudulit ose dita, kur Muhammedi (a.s) vuri Gurin e Zi në mur të Qabes. Më vonë ndodhen ngjarje të mëdha të historisë islame, si: zbritja e Kur'anit, Isra e Miraxhi, udhëtimi i Profetit (a.s) në Taif, etj. Mirëpo myslimanët iu dhanë data disa ngjarjeve që ndodhën pas emigrimit.

- Viti i parë quhet "Viti i lejimit", kur u lejuan myslimanët të luftojnë për të ruajtur veten, pasurinë, familjen, fëmijët dhe vendin e tyre.

- **Viti i dytë quhet "Viti i urdhrit"**, kur myslimanët u urdhëruan për të luftuar. Në këtë vit u bë lufta e Bedrit. U urdhëruan gjithashtu të agjërojnë Ramazanin, të japin zeqatin, fitrin, të sillen me fytyrë nga Qabja gjatë faljes.

- Viti i tretë quhet "Viti i provimit", kur u bë lufta e Uhudit, në të cilën u vranë 70 luftëtarë myslimanë. Kjo qe një provë e vështirë për hipokritët, që u shfaqën gjatë asaj lufte.

1. Tregojnë se një arab shiti disa mallra në Mekë. Blerësi nuk i pagoi paratë. Arabi u ankua. U mblodhën njerëzit para Mekës e vendosën të jenë më të drejtë dhe më të rreptë kundër kujtdo që sillet keq me të huajt.

- Viti i katërt quhet "Viti i ndalimit", sepse në atë vit u ndalua alkooli dhe pijet dehëse dhe u përzunë çifutët Benu Nadire nga Medinja, mbasi deshën të mbytnin Profetin (a.s). Ata kërkuan që të lejoheshin të largoheshin me mall e gjë. Kjo e drejtë iu dha, por nuk u lejuan të largoheshin me armë.

- Viti i pestë quhet "Viti i zelzeles", sepse në këtë vit idhujtarët e Mekës me 10.000 luftëtarë sulmuan Medinen. Çifutët Benu Kurejdha nuk ia mbajtën besën Profetit (a.s). I çelën kufirin fuqive të Mekës, që të sulmonin fuqitë islame pas shpine. Mirëpo kjo zerzele (tërmet) frikësuese kaloi, kur u prish marrëveshja midis çifutëve me idhujtarët e Mekës. Zoti (xh.sh) u dërgoi banorëve të Mekës një furtunë të madhe me errësirë, ua prishi çadrat dhe u fiku zjarret. Atyre u hyri frika dhe së fundi u kthyen nga lufta pa fituar gjë.

> **Me emigrimin triumfoi Islami dhe myslimanët u qetësuan, vunë gurin e parë të qeverisë islame. Kështu Islami, mbasi ishte në fillim besim e mendim, kaloi në zbatim e në veprim. Në këtë mënyrë u formua një bashkësi (komunitet), ku zbatoheshin urdhrat e Zoti, ku spikatnin shpirti, rregulli, statuti dhe sjelljet morale e karakteri i mirë.**

- Viti i gjashtë quhet "Viti i kënaqësisë", sepse në këtë vit myslimanët ranë dakord me idhujtarët e Mekës të ndalojnë luftën për 10 vjet.

Kështu u kënaqën myslimanët, sepse filluan lirisht të përhapin fenë islame edhe jashtë Medines, si në Meke, e në disa vende të tjera.

- Viti i shtatë quhet "Viti i fitores", sepse në këtë vit u dërmuan çifutët e Khajberit nga myslimanët, derisa kërkuan paqe. Në këtë vit gjithashtu Profeti (a.s) dërgoi letra në vise të ndryshme me thirrjen për të hyrë në Islam. Letra të tilla u dërgoi mbretit të romakëve, Kisrasë së persëve, Mukaukisit të Egjiptit, Nexhashiut në Abisini dhe sa e sa sunduesve arabë.

- Viti i tetë u quajt "Viti i fitores së madhe", kur u mor Meka nga myslimanët, thuajse pa luftë.

Në atë vit u kthye Profeti (a.s) me emigrantët në vend të vet mbas tetë vjetësh. Ai e pastroi Qaben dhe Mekën me rrethet e saj nga idhujt (ikonat). Ai Zotëri i fali të gjithë armiqtë e mëparshëm. Po atë vit u bë edhe Lufta e Taifit e cila njihet si lufta e fundit me arabët.

- Viti i nëntë u quajt "Viti i pastrimit", sepse në atë vit u shpall pastrimi i Qabes nga idhujt, si edhe vendet e tjera dhe u ndaluan idhujtarët për të hyrë në Qabe, përveç atyre që kishin besë deri në një afat të caktuar. E kur t'u mbaronte afati, edhe ata ndaloheshin. Ky vit u quajt edhe "Viti i delegatëve"', sepse në atë vit erdhën delegatë nga shumë vise dhe vende të ndryshme në Medine për të deklaruar pëlqimin e fesë islame.

- Viti i dhjetë quhet "Viti i ndarjes", sepse në këtë vit Profeti (a.s) bëri pelegrinazhin (haxhin) për herë të fundit dhe u tha shokëve se ndoshta nuk do të shiheshin më në atë vend. Me këtë rast mbajti ligjëratën e famshme që qe fjalimi i lamtumirës. Mbas saj, në muajin e tretë të vitit të njëmbëdhjetë, ndërroi jetë Profeti (a.s).

EMIGRIMI ËSHTË FILLIMI I KALENDARIT ISLAM

Mbas Profetit u zgjodh kalif Hz. Ebu Bekri. Ai luftoi kundër tradhtarëve të fesë që ndaluan zeqatin, pastaj organizoi përmbledhjen e Kur'anit. Si kalif jetoi vetëm dy vjet e vdiq.

Mbas tij u zgjodh kalif Hz. Omeri, i cili vendosi kalendarin islam. Ja, si ndodhi. Atij i erdhi një letër me datë të muajit Shaban. Ai pyeti: "Cili Shaban, çfarë viti? Nuk mori përgjigje.

Për këtë mblodhi Këshillin e njerëzve të mëdhenj. Mbasi u kallëzoi shkakun e mbledhjes, i pyeti se çfarë duhej të bënte. Njeri tha që persianët kishin një kalendar, le të marrim atë që përdorin ata. Ky propozim nuk i pëlqeu Hz. Omerit. Një tjetër tha që të merrej kalendari romak. Edhe kjo nuk i pëlqeu, prandaj ra në mendime për një kohë të gjatë. Në këtë gjendje i erdhi një letër nga shoku i vet, Ebu Musa, ku shkruhej: Na vijnë letra prej jush pa datë, na vini një datë." Në këtë rast Hz. Omeri tha: "Pse nuk e marrim emigrimin si fillimin e kalendarit islam? Ajo duket koha më përshtatshme dhe më fortë e lidhur me Islamin."

Të gjithëve u pëlqeu mendimi i tij dhe e vunë në zbatim duke e filluar me muajin e parë MUHARREM, sepse në atë muaj filloi emigrimi i myslimanëve, kurse Profeti (a.s) emigroi në muajin REBUL-EVVEL, në muajin e tretë të vitit.

Që atëherë filloi të zbatohet kalendari mysliman. Muajt e këtij kalendari janë: 1. Muharrem. 2. Sefer. 3. Rebiul-Evvel. 4. Rebiul-Ahar. 5. Xhemadal-Evvel. 6. Xhemadal-Ahar. 7. Rexheb. 8. Shaban. 9. Ramazan. 10. Shevval. 11. Dhil-Kade. 12.Dhil-Hixhe.

ISLAMI, PARA E PAS EMIGRIMIT

Kur kremtojmë në muajin Muharrem emigrimin e Profetit (a.s), është mirë të paraqesim gjendjen e Islamit dhe të njerëzve të tij para e pas emigrimit. Kështu do ta çmojmë më mirë emigrimin, do ta kuptojmë më mirë shkakun e tij dhe do të njihemi me të mirat që u erdhën myslimanëve në këtë rast.

Në fillim duhet të përshkruajmë vështirësitë që ka kaluar Islami, sa vuajtën e u munduan myslimanët të arrijnë të përvetësojnë e të ndjejnë me zemër fenë islame në atë epokë gjakpirëse, plot tortura e ndeshje të liga, se kështu do kuptojmë se çfarë pësuan besimtarët në kurriz, në pasuri e në ndërgjegje.

Kurse mbas emigrimit, Islami u përhap si drita që zhdavarit errësirën . U përhapën myslimanët në shumë vende duke propaganduar fenë pa rrezikuar jetën.

Para emigrimit, Islami u përmend si parime e vendime, mirëpo ato nuk gjenin terrenin e duhur për zbatim, që të jetohej në bazë të tyre, sepse në Mekë sundonin me dhunë, pa lejuar asnjë person që t'i shmangej rregullave të jetës së vendit. Aq të forta e të egra ishin ndjekja dhe torturat, saqë njeriu frikësohej ta shpallte veten në fenë islame, të pëlqyer nga prindërit e vet, nga nëna, babai, motra e vëllai.

Në atë kohë myslimanët jetonin në varfëri dhe ishin të dobët. Ata nuk guxonin të shpallnin e të përhapnin kërkesat e jetës së tyre, madje disa dilnin jashtë Mekës, rrëzë malesh për t'u falur të lirë. Megjithëkëtë zemrat e tyre ishin të mbushura me gëzim.

Mbas emigrimit myslimanët e deklaronin hapur fenë e tyre, mburreshin me të dhe mblidheshin si një familje, grumbulloheshin në xhami për t'u falur duke zbatuar kërkesat e islamit me liri të plotë e me siguri, të ndihmuar nga Zoti (xh.sh).

Para emigrimit feja islame ishte e kufizuar vetëm në Mekë dhe në ndonjë vend tjetër pranë saj. Nuk lejohej që kjo dritë të dilte në vende të tjera, kurse mbas emigrimit, drita islame ndriçoi e filloi të lëshojë rrezet e veta në çdo vend të kësaj bote, në veri e në Jug, në lindje e në perëndim.

I PARI FJALIM I PROFETIT MUHAMMED (A.S) NË MEDINE

Profeti (a.s), sapo arriti në Medine, menjëherë filloi të ndërtonte xhaminë. Sapo mbaroi ndërtimi i asaj xhamie modeste, ai mbajti fjalimin e parë, në të cilin kërkoi prej myslimanëve që të jenë vëllezër, t'i bëjnë mirë njëri-tjetrit, të bashkëpunojnë, ta duan njëri-tjetrin, të jenë të bindur, të largohen nga idhujtaria e grindjet, të mos e humbin besën që japin.

Gjendja ishte shumë e gëzueshme. Me kërkesën e tij u arrit që çdo njeri nga Medina të bëhet vëlla me një emigrant nga Meka. U çuan ensarët (medinalitë) të kryenin detyrat e vëllazërisë, iu hapën shtëpitë emigrantëve, iu shtuan sofrat për të ngrënë e për të pirë, nuk kursyen asgjë për ta, madje njëri bëri një gjë të çuditshme, që nuk ngjet edhe në mes dy vëllezërve nga një nënë e një baba.

Abdurrahmani, djali i Aufit u bë vëlla me Saidin, djalin e Rebiut. Saidi, duke biseduar me vëllanë e ri, i tha: "Kam shumë mall e pasuri, të jap gjysmën; kam dy shtëpi, të jap njërën...."

Abdurrahmani e falënderoi dhe i tha t'i kallëzonte të nesërmen se ku është tregu, sepse ai dinte të bënte tregti. Të nesërmen Abdurrahmani shkoi në treg, bleu mallra duke marrë borxh, fitoi mjaft para dhe e pagoi borxhin. Pak nga pak u bë një nga pasanikët më të mëdhenj të vendit.

Kështu filloi bashkëpunimi mes vëllezërve myslimanë në fusha të ndryshme: tregti, bujqësi, mjeshtri etj, ku bënë punë shumë të mëdha. Për shembull: Medinalinjtë blinin armë nga jehuditë. Me ardhjen e myslimanëve nga Meka në Medine, filluan t'i bënin vetë armët e tyre. Kështu nuk patën më nevojë të blinin armë nga armiku.

Ç'KA THEKSOI EMIGRIMI?

Në të vërtetë mund të flasim për shumë probleme, por ne po theksojmë disa fakte, të cilat na vlejnë për jetën e sotme.

Emigrimi theksoi se e drejta është fuqi, kurse dobësia është asgjë.

Torturat dhe hallet që u shkaktohen njerëzve të mirë, nuk mund ta mposhtin fuqinë e besimit, nëse zemrat lidhen fort me të (këtë e kemi parë tek shumë njerëz në vendin tonë gjatë regjimit komunist, sikurse ka ngjarë edhe në Rusinë staliniste).

Emigrimi theksoi se vendlindja nuk ka vleftë për të jetuar pa nder, pa të drejtën e pronës, të lirisë së besimit e të fesë.

Emigrimi theksoi rolin e vëllazërimit islam dhe shprehu qartë se ai është besë ndërmjet zemrash dhe një marrëveshje për të jetuar në marrëdhënie të larta njerëzore.

Gjithashtu emigrimi tregoi se besimi provohet me vuajtje e vështirësi, kapërcimi i të cilave e mbush zemrën me fuqi e kurajo.

Besimi në Zotin (xh.sh) nuk dobësohet nga pengesat e vuajtjet, njeriu nuk pendohet e nuk humbet kurrë shpresën në Zotin (xh.sh).

Emigrimi provoi se durimi, bashkimi e bashkëpunimi, lidhja me besim në Kur'an bën gjëra të çuditshme, si të thuash mrekulli dhe u siguron myslimanëve frytet më të mira.

Këto janë disa vlera të emigrimit prej të cilave ne edhe sot mund të nxitemi për tu përballur me armiqtë e shumtë të fesë.

A thua po e zbatojmë ne myslimanët vëllazërimin mes nesh, ashtu siç desh Profeti (a.s)? A thua po i harrojmë ngatërresat në mes nesh, duke qëndruar të gjithë të bashkuar në një radhë e të shtrënguar fort pas njëri- tjetrit?

A po e pastrojmë vendin tonë nga të huajt që na duan të keqen e sjellin ngatërresa e përçarje? A po e pastrojmë jetën tonë nga idetë false, a po i largojmë nga mendja dhe jeta jonë ato parime dhe ideologji rrënuese dhe të mbështetemi në parimet e Kur'anit Famëlartë, në Traditën e Profetit (a.s), në mendimin e drejtë e të nderuar të dijetarëve të shquar në fushën e fesë dhe në atë çfarë kanë zbuluar intelektualët e njohur dhe të shquar në fushat e ndryshme të diturisë e sidomos në ato të sjelljeve të mira e të marrëdhënieve të drejta njerëzore.

Ai që nuk mbështetet në shtyllat e fesë dhe largohet nga kërkesat e tyre, ai pa fjalë do të shkatërrohet në këtë jetë dhe në jetën e ardhme, ashtu sikurse kemi lexuar për shumë njerëz, popuj, kombe dhe ide.

Zoti (xh.sh) ka thënë në Kur'anin Famëlartë: "O besimtarë, nëse zbatoni urdhrat e Zotit (xh.sh), Ai ju ndihmon e ju jep fitore."[2]

I drejtohem Zotit (xh.sh) të na pranojë lutjen tonë, të na japë të mira në këtë jetë dhe në jetën e ardhme, sepse Ai është Ndihmës dhe përherë Udhëzues në rrugën e drejtë.

2. Kur'ani, Muhammed: 7.

SHPREHJE ZEMËRIMI DHE DËNIM I AKTEVE TERRORISTE

Myftinia Shkodër dënon aktin terrorist të djegies së një xhamie, mbrëmjen e kaluar, më 10 mars 2018 në Berlin të Gjermanisë.

Akte të tilla janë shenjë e qartë e urrejtjes dhe vullnetit të hapur të grupeve terroriste, që janë të ineresuara për mbjelljen e pasigurisë, përhapjen e frikës dhe mbi të gjitha, shfaqjen e islamofobisë dhe urrejtjes shekullore ndaj Islamit dhe muslimanëve, që historikisht kanë ndërtuar ura të komunikimit dhe dialogut, kudo e me këdo!

Evropa është në borxh me muslimanët dhe vlerat qytetëruese që ata përhapën në vende të ndryshme të saj, duke u bërë shkak për nxitjen dhe përhapjen e dritës së dijes dhe vlerave më të spikatura të qytetërimit dhe përparimit, që qëndrojnë në zanafillën e Thirrjes Islame.

Kohëve të fundit, thirrjet ekstremiste të klasave të ndryshme politike në vende të ndryshme të Evropës, kundër emigrantëve dhe muslimanëve në veçanti, janë sinjale negative që nxisin

frymëra mesjetare, të mbushura me injorancë dhe primitivizëm, urrejtje dhe intolerancë të papranuar nga logjika e shëndoshë njerëzore!

Myftinia Shkodër dënon aktet e dhunës, thirrjet e saj dhe çdo përpjekjet për mbjelljen e farës së urryer të terrorizmit, intolerancës dhe islamofobisë, sikurse nxit përherë respektin e lirisë fetare dhe shenjtërinë e objekteve të kultit, kudo e kurdoherë!

Lutjet tona janë që fryma e paqes dhe e qytetërimit të vlerave të dominojë kudo, që njerëzit të jetojnë në paqe me njëri-tjetrin dhe askush të mos dhunohet a të paragjykohet për lirinë e besimit dhe përzgjedhjen e tij fetare!

Shkodër, 11 mars 2018

MYFTIU APELON PËR MË SHUMË PËRGJEGJËSI NË RAPORT ME GJENDJEN E PËRMBYTJES

Paraditën e së hënës, më 19 mars 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, inspektoi në terren gjendjen aktuale të Xhamisë së Plumbit, e cila ndodhet nën ujë, si pasojë e përmbytjeve të javëve dhe ditëve të fundit.

Për mikrofonin e Tv1 Channel, Myftiu i Shkodrës përsëriti se, tashmë nuk bëhet fjalë thjeshtë për një objekt adhurimi të përmbytur, por për njerëzit e rrezikuar në zonat, ku përmbytjet e ditëve të fundit po marrin masa të frikshme, që na kujtojnë vitin 2010.

Myftiu tha se, shpresa në qeverinë turke dhe institucionet e saj është e madhe, në lidhje me ndërhyrjen që mund ta shpëtojë këtë xhami shekullore, monument kulture.

Përtej kësaj, Myftiu bëri thirrje për më shumë përgjegjësi nga qeveria dhe institucionet, në lidhje me situatën emergjente të përmbytjes së këtyre

ditëve, që nuk është e re në Shkodër.

Ai tha se, nuk është koha e retorikave boshe, por e bashkëpunimit në shërbim të jetës dhe mirëqenies së njerëzve dhe se çdokush duhet të marrë përgjegjësitë që i takojnë.

NDIHMAT E TURQISË PËR TË PËRMBYTURIT E SHKODRËS

Më pyetën sot, ca miq të afërt nëse është e vërtetë se, Turqia do të sjellë ndihma të konsiderueshme për të përmbyturit e Shkodrës.

E ndjeva për borxh moral të them dy fjalë, që do t'i ndaj edhe me ju, me shumë dashamirësi.

E vërteta e madhe, që nuk duhet ta mbulojmë për asnjë konjukturë, është se, Turqia e presidentit Rexhep Taip Erdogan është kthyer sot, në një kible garancie dhe besueshmërie për pjesën dërrmuese të ymetit të muslimanëve në mbarë botën, kible humanizmi, dijeje, përparimi, zhvillimi dhe rimëkëmbjeje të paevitueshme, që ngroh dhe gëzon pa masë zemrat e dashamirëve.

Në sytë dhe mendimet e elitave të mendimtarëve tanë botërorë, kjo Turqi, është mëse e denjë të jetë pikë referimi për botën islame dhe të garantojë rizgjimin e munguar të mbarë ymetit, edhe pse shumë të fabrikuar nga ambasada e shtete që e kanë luftuar dhe e luftojnë Islamin, (edhe në mesin tonë), nuk e duan dhe propagandojnë çdo ditë kundër saj dhe zhvillimeve befasuese, që ajo po kalon!

Ymeti islam, (Ehli Syneti), është ymet pjellor, nuk vdes, edhe nëse dërrmohet për vdekje, siç është sot, falë bashkimit të aleancave të së keqes kundër tij! Ai nuk mbetet peng në duart e modeleve të shpifura dhe dekadente, që qenë krijuar për të garantuar kolonizimin e botës islame, si viruse shkatërruese të ymetit, të prodhuara shekullin që kaloi.

Edhe viruset e këtij shekulli me ushtarët e tyre të përbetuar, nuk e mbajnë dot peng rizgjimin e një ymeti, që ka për Zot, All-llahun (xh.sh.) dhe për pejgamber, Muhammedin (a.s.), në fjalët e garantuara të cilit gjejmë shpresë dhe besim se, e ardhmja është e Islamit!

Nga ana tjetër, ne si komb shqiptar, duhet të ndjehemi krenar dhe të sigurt, që Turqia ka qenë, është dhe lutemi që do të vazhdojë të jetë miku ynë i madh dhe atdheu i shtrenjtë i miliona shqiptarëve, që sot jetojnë në integritet të plotë, thuajse në çdo cep të saj, duke ruajtur gjuhën, besimin, fenë dhe traditat e të parëve!

Ndihmat e qeverisë turke janë të mirëpritura me zemër, sikurse mirënjohja e jonë ndaj saj nuk ndryshon, edhe pa këto ndihma humanitare, që vijnë si bekim e fije shprese për qindra familje në mizerie..!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, 23 mars 2018



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

"Pasha Atë që shpirti im është në dorën e Tij, nuk do të hyni në xhenet derisa të besoni dhe nuk do të besoni derisa të doni njëri-tjetrin. A t'ju treqoj për diçka, të cilën nëse e veproni do të doni njëri-tjetrin? Përshëndeteni me selam njëri-tjetrin"

(Transmetuar nga Muslimi)

DËSHMOJE SE NUK KA ZOT TJETËR, POS TIJ!

"Zoti im është më i Madh sesa "Uni im"
dhe udhëzimi i asaj që erdhi i Dërguari i Tij
do të jetë rruga e vetme e qetësisë shpirtërore dhe mendore i jetës sime".

Ervil Kuçi,
imam, xhamia Dërgut

Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër, pos Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Tij! Kjo frazë në ymetin islam quhet "Shehadeti" (Dëshmia, ose Dy dëshmitë).

Ajo është fraza e parë, me të cilën përballet njeriu, atëherë kur vendos t'i nënshtrohet Zotit të tij.

Ndoshta edhe pa e kuptuar në të vërtetë domethënien e saj, ose ndoshta duke e kuptuar atë përciptas, njeriu e shqipton me gojë dhe me kalimin e kohës e kupton domethënien e saj.

Një shqiptim i saj me sinqeritet dhe çdo njeri automatikisht pajiset me pasaportën e besimit në një Zot të Vetëm!

I gatshëm për nënshtrim ndaj Zotit të tij, i gatshëm për mirënjohje dhe falënderim ndaj çdo mirësie që iu dha në këtë botë që nga lindja e tij.

I gatshëm për të hapur një faqe të re në jetë, ndryshe nga ajo që është mësuar për vite me radhë, i gatshëm për pendesë ndaj shumë gabimeve, që deri para se të shqiptonte atë frazë ndihej krenar.

I gatshëm për t'i dëshmuar Zotit të tij që me të vërtetë Ai, Krijuesi i gjithësisë është më i Madhi në jetën e tij sesa tekat, dëshirat, epshet, tundimet që has dita ditës.

I gatshëm për të pranuar në zemrën e tij gjithë mirësinë që vjen pas kësaj dëshmie nga e vërteta të cilën përqafoi.

Nga e gjithë kjo gatishmëri ndërtohet si fillim ajo që quhet shtylla e parë e besimit, pra dëshmia me zemër dhe me bindje të plotë që: "Zoti im është më i Madh sesa "Uni im" dhe udhëzimi i asaj që erdhi i Dërguari i Tij do të jetë rruga e vetme e qetësisë shpirtërore dhe mendore i jetës sime".

Nëse shtylla e parë e besimit ndërtohet në këtë mënyrë, bazamenti është i fortë, do të përballojë çdo lëkundje, dhe shumë stuhi sprovash.

Por e gjitha kjo mbetet teori në letër, libër apo kudo qoftë e shkruar apo e lexuar dhe realizohet vetëm atëherë kur praktikohet gatishmëria në ato që përmendëm, që vjen si rrjedhojë e kësaj dëshmie.

Shpresoj që çdo mysliman i pjekur, me mendje dhe logjikë të shëndoshë, ta ketë përvetësuar këtë dëshmi në jetën e tij! E them ta ketë përvetësuar dhe jo ta dijë përmendësh, sepse qëllimi i saj i vërtetë në mënyrë që të japi frytet e veta, është të jetë e përvetësuar dhe jo të jetë mësuar përmendësh!

Megjithatë, realiteti është mbi shpresën dhe shumë myslimanë jo vetëm të pjekur por edhe me një mëndje tejet të shëndoshë e dinë vetëm përmendësh.

S'po flasim vetëm për ata myslimanë që kanë trashëguar vetëm emrin nga Islami, por edhe për ata që janë praktikantë të tij, të familjes së sexhdes!

Fakti që shumë myslimanë i shohim sot të luhatshëm në besim, jo të rregullt me dispozitat e fesë, neglizhentë ndaj namazit, ndaj zekatit, ndaj agjërimit etj, tregon qartë se shtylla e parë e besimit nuk është ndërtuar e fortë dhe solide, prandaj dhe shtyllat e tjera janë të dobëta dhe si pasojë krejt struktura e besimit lëkundet shpesh dhe është e brishtë ndaj stuhive të sprovave.

Kështu që, nëse duam një besim të fortë, që ta shijojmë ëmbëlsinë e tij, duhet ta dëshmojmë në çdo aspekt të jetës, që Zoti dhe ajo që e kënaq Atë, është më e madhe sesa egoja, neglizhenca, veset, epshet etj.

Nëse Allahu (xh.sh) të ka mundësuar të gjendesh në familjen e besimit, e gjithë ajo që duhet bërë është të dish të jesh brenda saj.

Një njeri shkoi tek Pejgamberi (a.s) dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut, më thuaj një vepër prej Islamit, të cilën nëse e veproj, nuk do të kem nevojë të pyes askënd tjetër, pas teje? Pejgamberi (a.s) i tha: "Thuaj kam besuar Allahun dhe përmbaju asaj!"

Allahu xh.sh na mundësoftë ta dëshmojmë Madhështinë e Zotit në çdo aspekt të jetës sonë dhe t'i përmbahemi mirësisë më të madhe, që na ka dhuruar Zoti, mirësisë së besimit. Amin!



MOSHA E TRETË NË EDUKATËN ISLAME



Besim Barbullushi, *Bursa - Turqi*

Islami na ka mësuar që marrja e dijes është detyrë për çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, i ri apo i moshuar. Njohuritë fetare u janë përcjellë njerëzimit në kohë të ndryshme dhe forma të ndryshme dhe çdo civilizimi u janë servirur dituritë (njohuritë) fetare "të shenjta". Sipas Islamit, arsimimi ka një rëndësi shumë të madhe dhe mund ta përkufizojmë me shprehjen "fillon në djep dhe mbaron në varr". Ajeti i parë që i zbriti të Dërguarit të Allahut Muhammedit (a.s) ishte "Lexo", ndërkohë që Profeti ishte 40 vjeç. I Dërguari i Allahut e ndau këtë dituri të shenjtë me sahabët e tij, që ishin në moshat nga më të ndryshme.

Do ndalemi në moshën e tretë dhe në nevojën e tyre për sa i përket njohurive fetare. Duke pasur parasysh dhe zhvillimet sociologjike të shoqërisë sonë, është mosha e cila ka përballuar "turbulencat" më të rënda të shoqërisë shqiptare. Pse them që mosha e tretë është më e "etur" përsa i përket dijes islame? Sepse moshat më të reja në ndryshim me këtë pjesë të shoqërisë janë aktive në kërkimin e saj, janë më të përshtatur me zhvillimet teknologjike, në ndjekjen e të rejave dhe në përdorimin e tyre.

Duke u nisur nga faktorët e ndryshëm social, historikë, psikologjikë etj, mosha e tretë është gjithmonë e më në rritje në krahasim me moshat e tjera, ky ndryshim i raporteve të moshave ka bërë që kjo moshë të zërë një vend të rëndësishëm në shoqëri. Paralelisht me këtë fenomen, nevoja për një "arsimim fetarë dhe edukatë fetare" është rritur, sidomos nga vitet e para të demokracisë deri në ditët e sotme.

Me afrimin e moshës së tretë për një person nuk duhet të kuptojmë thjeshtë ndryshimet fizike trupore, por dhe ndryshime të theksuara të ndjenjave. Por, problemi më i theksuar që qëndron është përshtatja e kësaj kategorie me rrethin e jashtëm dhe moshat e tjera. Duke marrë parasysh burimet fetare, vlerat dhe zakonet kulturore të shoqërisë, janë moshat e tjera që duhet të kenë më shumë kujdes në përshtatjen e tyre me këtë kategori moshe dhe duhet të jenë gjithmonë moshat e tjera që duhet të jenë më të kujdesshëm në sjelljet reciproke ndaj kësaj moshe.

Personat në këtë moshë kalojnë një "krizë" psikologjike të theksuar dhe është nevoja që të kenë një mbështetje dhe stimulim të fortë nga rrethi i jashtëm. Për cilën "krizë" bëhet fjalë? Është afrimi i vdekjes.

Njohuritë fetare në këtë periudhë mundë të themi se janë "ilaç" për kalimin me sukses të kësaj periudhe, duke pasur parasysh se si Islami e studion jetën pas vdekjes ose ahiretin. Në Kur'anin Famëlartë, Allahu (xh.sh) thotë: "Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen" - (Ali Imran 185), dhe në vazhdimin e këtij ajeti Allahu (xh.sh) premton se për çdo person do të ketë shpërblimin e kësaj jete, në varësi se si e ka kaluar atë. Këto burime dhe njohuri fetare janë mbështetje jo vetëm për moshën e tretë të shoqërisë, por për çdo person që e kupton se kjo botë është kalimtare.

Ndryshe nga moshat e tjera, mosha e tretë mund te jetë një hap mbrapa për marrjen e njohurive fetare, por kjo s'do të thotë se është një gjë e pa arrirë dhe e kushtëzuar. Vullneti, dëshira dhe nijeti i mirë kanë thyer çdo pengesë.

Në literaturën e "edukatës fetare" mosha e tretë në konceptin psiko-sociologjik përbëhet në dy faza:

1. "I perceptueshëm" (informal),
2. "I rastësishëm" (incidental).

Të moshuarit, zhvillimet sociale, vlerën e jetës, marrëdhëniet njerëzore dhe problemet, ose pengesat e hasura i lidhin ngushtë me zhvillimin e edukatës fetare, sepse vetë fenë e plotësojnë këto tri vlera: "dija, ndjenjat dhe veprat", pa këto tri vlera s'kemi të bëjmë më me një fe, por me një fenomen social.

Mosha e tretë është më e kufizuar në lëvizje dhe kjo sjellë edhe mungesën e komunikacionit me pjesën e jashtme të ambientit, prandaj kjo moshë është më e prirë në dëgjimin, leximin dhe ndjekjen e njohurive aktive.

Marrja e njohurive në këtë moshë kalon edhe në një fazë që quhet "mësim personal" (self directed learning) ose ndryshe e thënë "autodidakte", ku këtu kemi të bëjmë me vlera të larta akademike të një personi, ndryshe nga të tjerët, jemi ne që duhet të jemi në ndjekje të këtyre personave. Në historinë islame ka shumë dijetarë islamë që edhe në një moshë të thyer, nuk u ndalën kurrë në dhënien dhe marrjen e dijes, ku brez pas brezi edukuan ymetin islam me frymën dhe vlerat islame.

Njohuritë fetare në këtë periudhë mundë të themi se janë "ilaç" për kalimin me sukses të kësaj periudhe, duke pasur parasysh se si Islami e studion jetën pas vdekjes, ahiretin.

Vlen të përmendet, një "arsimim fetar" me moshën e tretë të shoqërisë duhet të jetë sa më spontan dhe më larg formalitetit, me një gjuhë të lehtë dhe popullore dhe larg akademikes, të jetë sa më e lehtë për tu kuptuar dhe arsyetuar. Mësimet fetare me këtë grupmoshë duhet të jenë të shkurtër dhe elastikë për sa i përket orareve dhe mjedisit. Siç e kemi përmendur edhe më lart kemi të bëjmë me një brez që kanë qenë pjesë e një periudhe 50 vjeçare e një regjimi totalitar komunist dhe ku feja ka qenë rreptësisht e ndaluar.

Respekti për të moshuarit është një detyrim për ne, kujdesi dhe mbikëqyrja është një vlerë e trashëguar nga të parë tanë. Një i moshuar në shtëpi, do të thotë një enciklopedi e gjallë, e cila është një burim vlerash historike, tradicionale dhe fetare. Pejgamberi ynë i dashur u sillte me një respekt shembullor ndaj kësaj moshe, ai u kërkonte mendimet dhe këshillat e tyre. Ky ishte një shembull për sahabët dhe të njëjtën sjellje e përdorën të rinjtë ndaj më të moshuarve të tyre.

Drama e pleqërisë nuk është plakja, por mbetja i ri!

U ZHVILLUA KONFERENCA E 7-TË VJETORE E IMAMËVE, TEOLOGËVE DHE THIRRËSVE ISLAMË TË SHKODRËS

Paraditën e ditës së mërkurë, më 28 shkurt 2018, Myftinia Shkodër organizoi konferencën e 7-të vjetore të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës, një aktivitet i përvitshëm dhe shumë i rëndësishëm i Myftinisë Shkodër.

Fillimisht, konferencën e përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili dha edhe mesazhin e rastit drejtuar imamëve.

Ndër të tjera Myftiu tha: "Imamët, thirrësit islamë, në veçanti, kanë një përgjegjësi të shumëfishtë kundrejt asaj që përhapet si zjarri në të thatë, në dëm të shoqërisë sonë, sidomos në raport me familjen, ruajtjen, konsolidimin dhe forcimin e saj me vlerat e qytetërimit islam, që bazohet në Kur'an dhe Traditat e Më të Mirit të njerëzimit, Hz. Muhammedit (a.s).

Ka shumë rëndësi, që nëpërmjet predikimeve të ndryshme, takimeve, bisedave, ndejave të shpeshta me besimtarë e qytetarë që interesohen për fenë e tyre, të vëmë theksin te domosdoshmëria e ruajtjes së familjes dhe forcimit të lidhjeve në mesin e antarëve të saj, për të dëshmuar bashkarisht madhështinë e shembullit islam në këtë drejtim."

Konferencën e përshëndeti edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, i cili vuri theksin tek domosdoshmëria e adhurimit në familje, veçanërisht në kryerjen e obligimit

të namazit. Ai foli për rëndësinë dhe dobinë që sjell namazi në mesin e familjes.

Më pas konferenca vazhdoi në dy seanca, sipas programit me temën kryesore të saj: **"Familja e shëndoshë islame"**:

"Familja përballë sfidave të modernitetit" - **Lavdrim Hamja**, imam - xhamia e "Dy Vajzave".

"Shtimi i divorceve dhe pakësimi i lindjeve, si dy fenomene alarmuese" - **Gilman Kazazi**, imam - xhamia "Ebu Bekër".

"Metodologjia e Pejgamberit (a.s) në zgjidhjen e problemeve bashkëshortore" - *Naim Drijaj*, imam - xhamia Parrucë.

"Përgjegjësia e edukimit të familjes" - **Arben Halluni**, teolog.

"Hz. Muhammedi (a.s) si model i kryefamiljarit të përkushtuar" - **Durim Kasemi**, Imam - xhamia Parrucë.

"Roli i xhamisë në edukimin familjar" - **Ruzhdi Plangaj**, imam - xhamia Kiras.

Tefsiri i ajetit: *"Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuroni zot tjetër, përveç Tij dhe me prindërit të silleni mirë"* - **Ervil Kuçi**, imam - xhamia Dërgut.

Në fund u dhanë edhe konkluzionet e konferencës dhe u lajmërua se materialet e plota të saj do të botohen në një botim të veçantë.

MYFTIU NISI NJË CIKËL TË RI HYTBESH MBI FAMILJEN NË ISLAM

Ditën e xhuma, më 2 mars 2018, nga minberi i xhamisë së "Dy Vajzave", Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, nisi një cikël të ri hytbesh mbi familje, rolin dhe vlerat e saj, sipas Kur'anit dhe Traditës së Hz. Muhammedit (a.s).

Në fillim të hytbes së tij, Myftiu lajmëroi të pranishmit, se në konferencën e 7-të vjetore të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës, u vendos që viti 2018 të jetë "Viti i Familjes", duke u përqendruar me krejt aktivitetin dhe dinamikën e tij rreth kësaj teme.

Myftiu tha se familja e sotme shqiptare është e kërcënuar nga propagandat shpërbërëse të shpirtit të tabanit islam, flamurtarë të së cilave janë media dhe politika.

Ai tha se Shqipëria është një vend islam, por se realiteti i familjes, ku po shtohen divorcet, lindjet e pakta dhe, ku po shtohen fenomene të shoqërive dekadente, si bashkëjetesa në mesin e dy

personave me gjini të kundërt, mbështetja e hapur ndaj të shthururve e të devijuarve, edhe me mbështetjen e organizuar të medias dhe politikës, na nxit edhe më shumë drejt një angazhimi maksimal për të mos pranuar këtë realitet dhe për të mbrojtur tabanin e familjes së shëndoshë islame dhe tradicionale shqiptare.

Njëkohësisht, Myftiu dënoi çdo lloj poshtërimi që i bëhet fesë islame dhe komunitetit më të madh fetar në vend, nëpërmjet pjesëmarrjes së ndonjë "biçim imami" në spote televizive të turpshme dhe pa asnjë vlerë!

27 MARS 2007 - 27 MARS 2018
11 VJET XHAMIA E RE E PARRUCËS

MYFTIU TAKOI IMAMËT PËR GJALLËRIMIN E AKTIVITETIT FETAR

Paraditën e së enjte, më 8 mars 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e Myftinisë Shkodër, në kuadër të gjallërimit të aktivitetit fetar.

Fillimisht, Myftiu falënderoi teologët pjesëmarrës në konferencën e 7-të vjetore, ku theksoi se teologët e Shkodrës vërtetuan se janë të aftë për projekte të tilla dhe se përgatitja e tyre i bën të aftë për përgjegjësi dhe angazhime që ia lartësojnë emrin dhe pozitën Myftinisë Shkodër dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Më pas, kërkoi që për çdo muaj, të ketë një hytbe kushtuar familjes dhe vlerave të saj në Islam.

Kohët e fundit po shohim sesi janë rritur propagandat kundër familjes tradicionale shqiptare, sesi media po

promovon modele dekadente dhe sesi politika po degradon në këtë drejtim, duke abuzuar dhe shkelur mbi tabanin kombëtar dhe atë fetar të shoqërisë sonë, në raport me vlerat e familjes.

Në këtë takim u diskutua edhe mbi disa çështje që lidhen me cilësinë e ligjërimit fetar, shtimin e aktiviteteve dhe rritjen e përgjegjësisë karshi besimtarëve dhe vetë qytetit.

MYFTIU LIGJËROI NË MBRËMJEN FETARE TË FRM, VJENË

Mbrëmjen e së shtunës, më 17 mars 2018, me ftesë të Forumit të Rinjve Muslimanë në Vjenë të Austrisë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ligjëroi para të pranishëmve të shumtë, mbi familjen dhe vlerat e saj në Kur'an dhe Traditat e Hz. Muhammedit (a.s).

Sipas faqes zyrtare të FRM, Vjenë, mësojmë se, "më 17 mars 2018, Forumi i të Rinjve Muslimanë – Dega Vjenë, organizoi me sukses tribunën islame me mysafir Myftiun e Shkodrës, Muhamed ef. Sytari që u paraqit para masës me ligjëratën: "Resulullahu si model i familjes myslimane".

Programin e begatë e pasuroi fjala përshëndetëse e nikoqirit, Drejtorit të Përgjithshëm të FRM, Mr. Amet Memeti dhe ajo e kryetarit të Bashkësisë Islame të Austrisë, z. Ibrahim Olgun.

Programin e udhëhequr nga Evzal Sinani e freskoi me lexim Kur'ani dhe ilahi, lexuesi i mirënjohur i Kur'anit, Zekirja ef. Kurtishi.

Befasia e natës ishte grupi i ilahistëve të vegjël "Nur" të përgatitur nga Mr. Ilire Halimi Poniku.

Para se të përfundohet programi me lexim Kur'ani u lexua një monolog nga hfz. Evzal Sinani, disa fjalë të Omerit (r.a.) që i ka thënë për hir të Muhammedit (a.s.) kur ka parë trupin e tij të bekuar pasi ka ndërruar jetë.

Manifestimi u vlerësua lart nga të gjithë të pranishmit dhe la mbresa të

mëdha dhe të thella te të gjithë mysafirët prezentë.

Ne, si grup organizativ i FRM-Vjenë, falënderojmë dhe çmojmë lart ardhjen e Myftiut të nderuar Muhamed Sytari dhe ef. Zekirja Kurtishit në Vjenë dhe falënderojmë gjithë pjesëmarrësit dhe ndjekësit e tribunës, me shpresë që ky organizim do jetë një pikë e vogël në detin e madh të davetit."

Të pranishëm në këtë mbrëmje të shënuar me vlera islame dhe kombëtare ishin imamë dhe prijës të ndryshëm të qendrave islame të Vjenës, mësues të lëndëve fetare në shkollat e Austrisë, të ardhur nga Zvicra etj.

Feja islame në Austri, njihet zyrtarisht me kushtetutë, që nga viti 1912, ndërsa mësimi i lëndës së fesë në shkollat e krejt vendit ka nisur që në vitin 1973.

Ndërkohë, ditën e dielë, më 18 mars 2018, me ftesë të Kryetarit të Bashkësisë Islame të Austrisë, H. Ibrahim Olgun, Myftiu i Shkodrës, i shoqëruar edhe nga Kryetari i FRM, Vjenë, z. Lutfi Xhemaili, ka zhvilluar një bashkëbisedim të ngrohtë e vëllazëror me drejtuesin e institucionit më të lartë islam të Austrisë.

NISI TRAJNIMI PERIODIK I IMAMËVE TË MYFTINISË SHKODËR

Ditën e mërkurë, më 21 mars 2018, në kuadër të trajnimit dhe kualifikimit të imamëve të Myftinisë Shkodër, me iniciativën e Myftiut dhe një grupi prej teologëve të specializuar të Shkodrës, nisi mexhlisi i leximit dhe komentimit të librit me titull: "Çështje të fikhut sipas Kuduriut", në medh'hebin hanefi.

Ky trajnim i domosdoshëm për krejt imamët, përveç se një mexhlis dijeje dhe këshillimi me dobi, ka për qëllim leximin, komentimin dhe përsëritjen e çështjeve thelbësore të fesë që lidhen me adhurimet ditore dhe paqartësitë e ndryshme që lindin si pasojë e zhvillimit të shoqërisë.

Në takimin e ditës së sotme, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, theksoi se ky mexhlis ka një vlerë dhe dobi të madhe, pasi synon përhapjen e dijes së dobishme, ruajtjen e traditave

shekullore në adhurim, si dhe kualifikimin e mëtejshëm të imamëve, si një proces i domosdoshëm në punën e vazhdueshme të prijësve tanë fetarë, që përherë kanë nevojë për organizime të tilla plot dobi për ta dhe komunitetin e besimtarëve. Në këtë trajnim janë të përfshirë të gjithë imamët dhe teologët e Myftinsë Shkodrës.

MEJTEPI I IM - XHAMIA BARDHAJ

PAK HISTORI:

- Xhamia Bardhaj, ndodhet në njësinë administrative "Rrethina", bashkia Shkodër. Përbëhet me rreth 150 familje, shumica e të cilave janë me përkatësi islame. Fiset më të mëdha janë: Fangaj (Dani), Selimi, Hyseni, Selmani etj.

- Pas rilejimit të besimit islam në vendin tonë, një prej ambienteve të banesës së familjes Selimi, me miratimin e Myftinisë së Shkodrës është përdorur si faltore për kryerjen e riteve të xhumasë dhe zhvillimin e kurseve fetare. Në këtë faltore (xhami) nga viti 1992- 2004 kanë shërbyer shumë imamë si: Ismet Ibishi nga Maqedonia etj.

Teologu Halluni në fillim mbajti një bisedë më nxënësit e xhamisë, duke u folur për rëndësinë që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që mbartim për të përçuar te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore dhe harmoninë me të gjitha krijesat e Zotit Fuqiplotë.

Më pas, drejtuesi arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga imami i xhamisë Ilir Dizdari dhe nevojat që ka xhamia për mirëmbajtjen e këtyre aktiviteteve mjaft të rëndësishme arsimore dhe edukative.

- Ndërsa në vitin 2004, me ndërtimin dhe hapjen e xhamisë së re në fshatin Bardhaj kanë shërbyer si imamë dhe mësues të mësim-besimit në periudha të ndryshme: Ajet Dani (2004-2005), Bledar Sulejmani (2006), Ilir Dizdari (2006- dhe në vijim).

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar 11 kurset e ndryshme fetare të besimit të zhvilluara në xhaminë e re nga viti 2008 - 2018, është rreth 260 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadrin e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim besimit, drejtuesi i tij, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim pune në xhaminë Bardhaj.

"Rrënja e mirësjelljes është besimi!

Ashtu siç jemi urdhëruar të falemi,

po ashtu jemi urdhëruar të themi të vërtetën.

Dhe, ashtu siç jemi urdhëruar

të agjërojmë Ramazanin,

po ashtu jemi urdhëruar

të mos i bëjmë keq njëri-tjetrit!"

Shejkh Vehbi S. Gavoçi

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek